

RAPORTI VJETOR 2025





RAPORTI VJETOR 2025

PËRMBAJTJA

LETËR NGA DREJTORJA EKZEKUTIVE E ARTPOLIS	1
RRETH ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET	2
RRETH RAPORTIT VJETOR 2025	3
EDICIONI I 13-TË I FESTIVALIT FEMART	4
PËRSHTYPJET E ARTISTËVE PËR FEMART 13	8
MEDIAT PËR FEMART 13	9
CIRCLE FEST – EDICIONI I PARË	10
PËRSHTYPJET E ARTISTËVE PËR CIRCLE FEST 1	13
KRYESORET NGA MEDIAT PËR CIRCLE FEST 1	14
SHFAQJET TEATRORE PROFESIONALE DHE PERFORMANCAT	15
SHFAQJA TEATRORE “VOJÇEKU”	16
POEZI PËR FUQI – ZË I REVOLTËS SË GRAVE	18
SHFAQJA TEATRORE “SHPIRTI”	20
SHFAQJA TEATRORE “KUJTIME NGA LUMI – PËR MANCE”	22
SHFAQJA FORUM TEATËR “PRAPA EKSPANIT”	24
SHFAQJA TEATRORE “KABARE 1999”	26
PREZANTIME JASHTË VENDIT	28
“KUJTIME NGA LUMI- PER MANCEN” NË NOVI SAD – PERFORMANCË DHE REFLEKTIM KOLEKTIV	29
SHFAQJA TEATRORE “GRATË E TROJËS”	30
SHFAQJA TEATRORE “REVOLTË. AJO THA. REVOLTOHU SËRISH.”	31
ARTIVIZMI FEMINIST	32
MARSHOJMË S’FESTOJMË – MARSHUAM PËR NJËRA – TJETRËN	33
KONFERENCA NDËRKOMBËTARE “ARTI + MENDJA: SHËRIMI, SHËNDETI MENDOR DHE BURNOUT NË REZISTENCËN KREATIVE”	34
PANEL DISKUTIMI NË UP: UNIVERSITET I SIGURT NGA NGACMIMI SEKSUAL 2025–2026	35
16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE	36
ARTPOLIS HAP “16 DITËT E AKTIVIZMIT” ME THIRRJEN PËR NJË UNIVERSITET PA NGACMIME	37
PANELI I DISKUTIMIT “HAPËSIRA TË SIGURTA NË UNIVERSITETE: DU STUDIME PA NGACMIME”	38
AKTIVIZMI FEMINIST NË NDËRTIMIN E PAQES	40
INICIATIVA TË ANGAZHIMIT TË ALUMNI: FUQIZIMI I GRAVE TË REJA DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT FEMINIST NDËRKUFITAR	41
TAKIMI TRANSNACIONAL NË PRISHTINË – FORCIMI I PARTNERITETIT – PROJEKTI HOPE	43
“UNMASC! PUNËTORITË E KËRKIMIT ARTISTIK: EKSPLORIMI I DREJTËSISË GJINORE PËRMES TEATRIT”	44
ZËRAT E SHPRESËS: TË RINJTË NDËRTOJNË PAQEN PËRMES ARTIT NË PRISHTINË	45
PUNËTORI MBI VLERËSIMIN E SHKOLLËS PRANVERORE FEMINISTE	46
TAKIMI I TRETË TRANSNACIONAL I PROJEKTIT UNMASC	47
THYERJA E BARRIERAVE: PUNËTORIA MBI BARAZINË GJINORE NË PRODUKSIONET ARTISTIKE	49
TEATRI SI KATALIZATOR NË NDËRTIMIN E PAQES: TRAJNIMET LOKALE ME TË RINJ NË KOSOVË	50
“KULTURA PA KUFI – NXITJA E DIALOGUT PËRMES ARTIT DHE KULTURËS”	51
FORMËSIMI I RRËFIMEVE TË PAQES: PUNËTORIA NDËRKOMBËTARE PËR TË RINJTË NË SARAJEVË	53
TAKIMI I TRETË TRANSNACIONAL NË SARAJEVË	54
SHFAQJA TEATRORE “DREAM ON”	55
SHKOLLA PRANVERORE FEMINISTE	56
DIALOGË TË TË RINJVE NGA KOSOVA DHE SERBIA - SHKËMBIM NDËRKUFITAR KULTUROR NË FEMART	57
UNMASC! NË FEMART 13: PREZANTIMI I PROJEKTIT DHE NJFOFTIM PËR PREMIERËN E ARDHSHEME	58
KONFERENCA VIRTUALE “JEHONAT E PAQES: RIIMAGJINIMI I HISTORISË PËRMES TEATRIT”	59

KLUBET TEATRORE DHE TRAJNIMI “EDUKIMI I BAZUAR NË TEATËR”	61
KLUBI TEATRORE NË FERIZAJ	62
SHFAQJA FORUM TEATËR “ZHULIETA E ZHULIETA” SFIDON NORMAT SHOQËRORE PËRMES DASHURISË	63
KLUBI TEATRORE NË PEJË	64
VAJZAT SFIDOJNË NORMAT PËRMES SHFAQJES FORUM TEATËR “ANDRRA E NJË NATE VERE”	65
TEATRI SI SHKOLLË JETE: “YOUTH NETWORKING EVENT” BASHKON TË RINJTË E KLUBEVE TEATRORE	67
THEMELOHET KLUBI TEATRORE NË SUHAREKË	69
“PLANI SEKRET” ME MESAZHE MBI NDIKIMIN POLITIK NË SISTEMIN ARSIMOR	70
THEMELOHET KLUBI TEATRORE NË GJILAN	71
“A PO M’NIN” – NJË PASQYRË E GUXIMSHME E DILEMAVE TË RINISË	72
FUQIZIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR	73
DOKUMENTARI “BIBA MAY – JO MË”	74
RRITJA DHE NGRITJA E KAPACITETEVE TË ARTPOLIS	75
PUNËTORIA “ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT DHE VLERËSIMI I PUNËS”	76
ARTPOLIS THEMELON STACIONIN KULTUROR	77
ANDI HAZIRI ZGJIDHET KRYETAR I ANËTARËSISË SË ARTPOLIS	78
PJESËMARRJE NË PUNËTORINË PËR LIDERSHIP NË AGJENDËN PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË	79
VIZITAT DHE BASHKËPUNIMET	80
DISA NGA VIZITAT QË ARTPOLIS MIRËPRITI PËRGJATË VITIT 2025 DHE BASHKËPUNIMET JASHTË ZYREVE TË ARTPOLIS ISHIN:	81
VLERËSIMI DHE MONITORIMI	84
SFIDAT DHE MËSIMET E NXJERRA	84
BLLOGJET	86
STATISTIKAT E VITIT 2025	87
STATISTIKAT E MEDIAVE SOCIALE	88
MONITORIMI I MEDIAVE	89
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	90
TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA DONATORËT	91
STAFI DHE BORDI I ARTPOLIS, 2025	92
DONATORËT E ARTPOLIS	93
RRJETET SOCIALE TË ARTPOLIS DHE FESTIVALIT FEMART	94

Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet

Adresa: Mujo Ulqinaku Rr, 8/8 (Pejton)

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: + 383 38 221 512

E-mail: ojq.artpolis@gmail.com

Facebook: <https://www.facebook.com/artpolisKosovo/>

Instagram: <https://www.instagram.com/artpoliscenter/>

Vimeo: <https://vimeo.com/artpoliscenter>

LETËR NGA DREJTORJA EKZEKUTIVE E ARTPOLIS



Të dashur artiste, aktiviste, donatorë dhe mbështetës të Artpolis,

2025 ishte një vit ku bota duket se po humbet frymën. Luftëra, pasiguri, dhimbje—dhe një peshë e rëndë mbi mendjet tona. Por arti vazhdoi të jetë ajo frymë e parë që na kthen veten. Artvizmi feminist nuk ishte vetëm një formë shprehjeje; ishte një mënyrë për t'u parë, reflektuar e shëruar.

Edicioni i 13-të FemArt, sërish, ishte një strehë për mendjen. Një vend ku gratë u takuan për të thënë se shëndeti mendor nuk është luks, por e drejtë. Ku çlirimi i mendjes nuk ishte vetëm metaforë—ishte praktikë. Në skenë, në biseda, në performanca, ne pamë se kur një grua gjen zërin e saj, është një akt që thotë: “Unë jam këtu. Unë jam e lirë”.

Circle Fest erdhi si një frymë e re. Një festival për artistët e rinj që ende nuk janë dëgjuar mjaftueshëm. Aty ku talenti nuk kërkon leje për t'u shfaqur. Aty ku çdo zë i ri gjen një skenë, një shesh, një komunitet.

Një kujtesë e thjeshtë: artisti i ardhshëm mund të jetë i pranishëm tani.

Por më shumë se festivale, 2025 ishte viti i një premtimi. I fillimit të një ëndrre që do të bëhet shtëpi. Stacioni Kulturor po lind—një hapësirë e përhershme për artin, artvizmin, edukimin feminist dhe bashkëpunimin komunitar. Nuk është thjesht një ndërtesë. Është një vend ku zërat e heshtur do të gjejnë zë. Ku shpresa do të marrë trup.

Ky raport është dëshmi e këtij rrugëtimi. Dhe unë jam mirënjohëse që jeni me ne në këtë rrugë—për të krijuar, për të shëruar, për të ndryshuar.

Zana Hoxha

*Themeluese / Drejtoreshë Ekzekutive e Artpolis
dhe Festivalit FemArt*

RRETH ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET

Artpolis është organizatë joqeveritare që përmes kulturës, artit, edukimit dhe dialogut social ndikon në komunikimin dhe transformimin pozitiv të bashkëjetesës në komunitet.

E themeluar më 2004, vizioni i Artpolis është të krijojë një shoqëri të bazuar në vlera feministe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Misioni i Artpolis është të ndërtojë fuqinë kulturore të grave dhe të rinjve për t'u bërë inspirimi dhe ndikimi i shoqërisë për ndryshim. Vlerat e Artpolis janë: feminizmi, barazia gjinore, drejtësia, paqja, edukimi, fuqizimi, emancipimi, humanizmi dhe besnikëria.

Artpolis identifikohet lehtë si një ndër organizatat unike, e cila e përdorë teatrin dhe format e tjera artistike për të afirmuar, avokuar, edukuar dhe promovuar të drejtat e grave, të drejtat e njeriut, të drejtat e grupeve të marginalizuara, barazinë gjinore, komunikimin me komunitetet multietnike, ndërtimin e paqes, fuqizimin e grave dhe të rinjve e të rejave. Ky aktivizëm artistik e bën të veçantë organizatën Artpolis, më afër qytetarëve, dhe ndërton relacione të sigqerta e më të fuqishme në komunikimin e përbashkët me komunitetin, duke gjetur përkrahjen e tyre. Ajo çka e dallon Artpolis-in nga organizatat e tjera joqeveritare është bashkëpunimi kreativ dhe edukativ me të rinjtë/rejat në nivel të lartë, përkrahja e komuniteteve pakicë, gjithëpërfshirja, diversiteti i grave në pushtet, ngritja e zërit kundër dhunës, pjesëmarrja aktive dhe masive e përkrahur nga komuniteti.

Disa nga aktivitetet kryesore të Artpolis janë: shfaqje profesionale teatrore, lexime skenike, trajnime, punëtori, konferenca, publikime, panele diskutimesh, ligjërata dhe diskutime publike, shfaqje filmash, koncerte, vallëzime bashkëkohore, protesta, marshe, fushata, performanca, pjesëmarrje në festivale teatrore jashtë vendit, aktivitete në rrugë me të rinj/reja, ekspozita, murale dhe instalacione, mbrëmje poezish, mbrëmje letrare dhe promovim librash, shfaqje forum teatër, mbrëmje përkujtimore të artisteve/ëve, joga dhe meditime, podkaste, intervista mediale, bashkëpunim me mediat dhe grupet artis-

tike ndërkombëtare, ndërtimi i relacionit me aktivistë ndërkombëtarë, edukim feminist, edukim teatrore, ngritje të kapaciteteve, buletini dy javor, rrjetet sociale, vullnetarizmi dhe takime me artistë.

Aplikimi i punës së Artpolis shtrihet në pesë shtylla:

Shtylla I – Bashkëndërtimi i lëvizjes feministe duke sfiduar mentalitetin patriarkal në shoqëri përmes artit dhe kulturës;

Shtylla II – Avokimi dhe mobilizimi i veprimeve kolektive në mbështetje të grave, pakicave, komunitetit LGBTQI, të mbijetuarave të dhunës dhe grave që mbrojnë të drejtat e njeriut;

Shtylla III – Fuqizimi i të rinjve nëpërmjet edukimit krijues dhe alternativ për të shprehur nevojat e tyre dhe për t'i dhënë formë të ardhmes së tyre në një shoqëri që bazohet në diversitet, barazi dhe drejtësi;

Shtylla IV – Krijimi i një vendi të sigurt për gratë dhe vajzat që të shprehen përmes artit dhe kulturës;

Shtylla V - Investimi në qëndrueshmërinë financiare dhe institucionale të Artpolisit.

Aktivitetet e Artpolis janë të shtrira pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës dhe në rajon, duke adresuar, trajtuar, ndikuar e ndërruar kufizimet e mendësisë patriarkale, duke ofruar vepra artistike e teatrore me artistë eminent të Kosovës dhe të rajonit, për qytetarët e në veçanti për të rinjtë e Kosovës; për të ngritur vetëdijen dhe angazhimin e tyre.

Artpolis - Qendra për Art dhe Komunitet ka një lidhje të ngushtë me mediat zyrtare të Kosovës, artistët e teatrit dhe filmit; është pjesëtare e ISPA-së (International Performing Arts Association; www.ispa.org), Rrjetit IETM, Rrjetit të Grave të Kosovës, Forumit Kulturor, CIVIKOS, Koalicionit për Shëndetin Riprodhues, Koalicioni i Kosovës për Pajtim dhe punon me artistë dhe aktivistë me prejardhje të ndryshme etnike.

RRETH RAPORTIT VJETOR 2025

Viti 2025 ka shënuar një periudhë të rëndësishme reflektimi, rritjeje dhe konsolidimi për Artpolis. Edhe pse sfidat strukturore, sociale dhe politike kanë qenë të pranishme, ato nuk e kanë zbehur angazhimin tonë të vazhdueshëm për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe solidare. Përkundrazi, këto rrethana kanë forcuar vendosmërinë tonë për të vepruar përmes artit, aktivizmit feminist dhe punës në komunitet.

Gjatë vitit 2025, Artpolis ka vazhduar me përkushtim misionin e fuqizimit të grave, vajzave dhe grupeve të marginalizuara, përmes një programi të larmishëm aktivitetesh që përfshijnë shfaqje profesionale, edicionin e radhës të Festivalit Ndërkombëtar FemArt, trajnime, punëtori, konferenca, diskutime publike, marshime, protesta dhe forma të tjera të ndërhyrjes artistike dhe aktivizmit shoqëror.

Një fokus i veçantë gjatë këtij viti ka qenë procesi i konsolidimit të qendrës kulturore Stacioni Kulturor, duke e zhvilluar më tej hapësirën tonë si një qendër e qëndrueshme për krijim artistik, edukim feminist, dialog shoqëror dhe angazhim qytetar. Ky proces konsolidimi synon jo vetëm zgjerimin e programeve, por edhe rritjen e ndikimit afatgjatë në komunitet dhe në skenën kulturore lokale dhe rajonale.

Ky raport pasqyron pesë shtyllat kryesore programore të Artpolis, të cilat vazhdojnë të udhëheqin vizionin, misionin dhe vlerat tona afatgjata. Në të njëjtën kohë, ai dokumenton progresin, arritjet dhe rezultatet kryesore të vitit 2025, duke ofruar një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve të realizuara dhe ndikimit të tyre në komunitet.

EDICIONI I 13-TË I FESTIVALIT FEMART



Gjashtë ditë. Nëntë hapësira. Mbi 180 artiste/ë dhe aktiviste/ë nga 19 vende të botës. 29 aktivitete. Mbi 3 mijë persona në audiencë. FemArt 13 nuk ishte vetëm festival – ishte frymëmarrje kolektive, një thirrje për çlirim të brendshëm, për shndërrimin e dhimbjes në forcë dhe të trupit në rrëfimtari të së vërtetës.

Çlirorje Mendjen – nuk ishte vetëm moto, por një udhëtim i thellë drejt shërimit. FEMART 13 ishte një rrugëtim i ndërtuar mbi guximin artistik feminist, i zërave që nuk heshtin ndaj stigmave shoqërore mbi shëndetin mendor, marginalizimit e shtypjes së shumëfishtë nga patriarkati.

Në mbrëmjen e parë, tingujt nga Shkodra Elektronike i dhanë jetë çlirimit të Prishtinës, të shpirtit e mendjes. Ky koncert ishte një shpërthim kolektiv i dashnisë, një ritual i ndriçimit të mendjes.

“Njerëz’t e mirë e njerëz’t pa emër, kërcejnë valle n’shpirot” – ishte kjo fjalia që po e merrte kuptimin e vetë teksa festa u hap, për ta reflektuar këtë

në gjashtë ditët në vijim të FemArt-it. Beatricja falendëroi organizatorët në mënyrë unike: që vazhdojnë më besu në andrra dhe dashni. Kjo formë e besimit duket sikur të mbush me jetë dhe sikur i bashkonte organizatorët, këngëtarët e publikun. Kur del nga salla e AMC krejt djers pas vallëzimit ke përshpirtjen se “Çlirorje mendjen” sikur se ndodhi”, shkruan Gili Hoxhaj në bllugun e saj “Shkodra Elektronike – si festë e përbashkët e çlirimit”.

Çliruese dhe thirrje për reflektim ishin edhe performancat e shfaqjet teatrore. **“Varrosjen e Turpit”** nga Marrja e Zezë – një ceremoni për të lënë pas turpin kolektiv që na është mësuar, ndërsa **“Zëra të Heshtur”** nga Italia i dha jetë trupave të heshtur, që për dekada s’kanë mundur të flasin. Kurse defatorët Shpejtim Smaqi dhe Sabahete Hasani i ngritën të gjithë në këmbë. Një gjuhë tjetër e trupit që s’kërkon fjalë për të thirrur të vërtetën. “Çdo ritëm thoshte: ‘Ne kemi mbijetuar’. Dhe çdo hap përgjigjej: ‘Dhe prapë ngrihem.’” – Shqipe Malushi.

Shfaqja **“Gratë e Trojës”** ishte globi ku mund të rrokulliset çdo histori lufte – e grave që ende jetojnë me to. Të grave që nuk patën zë për të dëshmuar për veten. Shfaqja dëshmon se arti është më i guximshmi. Arti i del përballë luftës më mirë se kushdo. Është i vetmi ku e vërteta mund të fitojë. Shfaqja **“Jam Unë Ajo”**, një prodhim i Teatrit të Gjilanit dhe Bon Production, preku thellë publikun. I riktheu nënat në përvoja të njohura dhe ngjalli ndjenja solidariteti – pavarësisht gjinive. Performanca **“AdH(A)rA”** nga Rhianon Morgan ishte një ftesë për të ndarë atë çast, ku zia na lejoj të zbulonim dëshirën tonë për të jetuar, për t’u zgjeruar, për të ecur përpara. Ishte një ftesë për t’u mbledhur, për të ndjerë, për të ndarë, për të jetuar, për t’u zgjeruar, për të ecur përpara. Së bashku.

Ndërsa **“Zëra të heshtur”** u bënë zëra që dëgjohen, e histori që lexohen. Performanca solli copëza nga eksploitimi seksual i grave. **“Të bëjnë të rimendosh krejt çka di për këtë temë: me keqardhje për gjithë paragjykimet që mund t’i keq mbjellur në vete”**, shkruan Gili Hoxhaj. Të rinjtë nga Italia përmes shfaqjes muzikore **“Qualcosa di Grande”** kërcyen dhe kënduan jo për t’i ikur kaosit të botës, por për ta përballuar atë—me zemrën përpara. Përmes një thurjeje të zgjuar muzikore, humori dhe kujtimesh, ata treguan historinë e një brezi shpesh të nënvlerësuar.

FEMART 13 solli edhe muzikë që i flet shpirtit. Përmes tingujve që shpesh janë të pazakontë, të guximshëm dhe të thellë, **“Liburn Jupolli Ensemble”** përmes **“Tales of Scapes”** krijoi një përvojë që të bën ta rimendosh se çfarë muzika mund të krijojë.

“Ansambli mishëroi shpirtin e bashkëpunimit artistik, duke ndërlidhur muzikën me teknologjinë dhe performancën, dhe duke sjellë në skenë një botë që flet për të ardhmen, ndërkohë që qëndron thellësisht e rrënjësuar në kërkimin e së vërtetës përmes artit. Për një art që kërkon më shumë të vërteta të tilla, skaje e përtej botës”, shkruan Gili Hoxhaj. Edh sivjet present ishin zërat e ëmbël të korit të grave **“Okarina”**, dhe në mbylljen plot dritë të Fête de la Musique, me **Tentative e Zwada**, muzika nuk ishte vetëm argëtim – por çlirim emocional.

FemArt vuri në pah gjithashtu histori të pathëna përmes filmit. Dokumentarët **“Në Kërkim të Burbuqe Rushitit”** dhe **“Kaskaderet”** nderuan gratë që kanë përdorur gazetarinë dhe fuqinë fizike si mjete të së vërtetës dhe qëndresës. Filmi artistik **“Guida Romantica a Posti Perduti”** hapi me delikatesë një bisedë mbi shëndetin mendor, pa e senzacion—duke nxjerrë në dritë vetminë, mohimin dhe ankthin që shpesh mbesin të pathëna.





Konferenca **ndërkombëtare “Art + Shërim, Shëndeti Mendor dhe Djegia Emocionale në Rezistencën Krijuese”** ishte një ditë e gdhendur me guxim dhe butësi. Nga Serbia në Ukrainë, nga Franca në Kosovë, artistë, antropologë dhe aktivistë qëndruan krah për krah, jo si ekspertë — por si dëshmitarë të dhimbjes, qëndresës dhe rilindjes.

Ky edicion shërbeu si urë lidhëse ndërmjet artisteve/ëve, aktivisteve/ëve dhe përfaqësuesve të institucioneve dhe festivaleve vendore e ndërkombëtare përmes **“Natës së Rrjetëzimit”** në Ambasadën e Luksemburgut e ndejave në Bubble Pub.

FEMART 13 u pasurua edhe me punëtori, diskutime feministe, **“Piknik dhe Meditim”** në Parkun e Qytetit,

e **“ngjarje aktiviste”** në Hamamin e Prishtinës duke dëshmuar se arti nuk është vetëm një formë e shprehjes, por një gjuhë e rezistencës dhe e shërimit, që ndikon thellë në jetën sociale dhe shpirtërore të komunitetit.

Me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare, program të pasur dhe ndikim të thellë kulturor e emocional, FemArt vazhdon të jetë një lëvizje feministe artistike që frymëzon, sfidon dhe transformon.

Ndaj, FEMART është këtu për të qëndruar – e gjallë, sfiduese, dhe e paharrueshme.

REZULTATET KRYESORE TË FEMART 12:

Mbi 180 artistë dhe aktivistë

Morën pjesë nga 19 shtete, përfshirë Austrinë, Shqipërinë, Belgjikën, Bullgarinë, Anglinë, Francën, Gjermaninë, Irlandën, Italinë, Kosovën, Korenë e Jugut, Luksemburgun, Maltën, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Zvicrën, Ukrainën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Shtrirje e gjerë digjitale

- 2,638,987 shikime gjithsej në video dhe fotografi në Facebook dhe Instagram
- 616,244 persona të arritur
- 20,586 vizita në profil
- 765 ndjekës të rinj

Publik i angazhuar dhe në rritje

- 3,036 pjesëmarrës morën pjesë në aktivitetet e FemArt 13
- 29 aktivitete të ndryshme të organizuara
- 14 blog poste të publikuara
- 37 artikuj të mediave të publikuara

Prani kulturore në të gjithë qytetin

Aktivitetet u mbajtën në 9 lokacione të ndryshme në Prishtinë: Salla AMC, Teatri Kombëtar, Teatri Oda, Instituti Francez, Parku i Qytetit, Hamami i Qytetit, Hani i Dy Robertëve, Bubble Pub dhe Ambasada e Luksemburgut.

11 vullnetarë kontribuan me kohën dhe energjinë e tyre, të mbështetur nga një koordinatore e përkushtuar.

PËRSHTYPJET E ARTISTËVE PËR FEMART 13

“Natën e kaluar ishte një mbrëmje mahnitëse. Më lind pyetja sa shumë intensitet dashurie mund të mbajë një zemër e vetme, sepse e imja, dje, u prek, u mbush dhe u përfshi nga flakët. Faleminderit, FemArt,” shkroi Beatrice Gjergji (Shkodra Elektronike) në faqen e saj në Facebook.

“Një nga shumë gjërat që janë mahnitëse në Kosovë është se është një shtet i vogël dhe me kaq shumë festivale dhe ‘FemArt’ është një festival shumë i veçantë. Diplomacia feministe është një prej prioriteteve tona, sepse të drejtat e grave, të drejta e LGBT-së janë esenciale për një shoqëri, për të qenë të lirë, jo vetëm në aspektin e jashtëm, por të lirë edhe nga brenda, andaj jemi shumë të lumtur t’i mbështetim aktivitetet feministe, sidomos ‘FemArtin’”, ka thënë Ambasadori i Francës, Olivier Guérot, në një deklaram për KOHA.

“Ishte një nder i vërtetë të prezantoja performancën time solo dhe të drejtoja një punëtori në FemArt — një festival frymëzues i formësuar nga zemra, fuqia dhe kujdesi. Falënderime të mëdha gjithë ekipit të FemArt për ngrohtësinë, profesionalizmin dhe hapësirën fuqizuese që krijojnë.” – AdH(A)rA, Rhiannon Morgan, Luksemburg.

“Mirënjohës për mundësinë që patëm të bëhemi pjesë e një festivali kaq domethënës dhe frymëzues — mbështetja dhe ngrohtësia juaj i ofruan ekipit tonë nga Ukraina një hapësirë shumë të nevojshme për të ndarë, për t’u lidhur dhe për t’u dëgjuar. Kjo përvojë mbetet me ne dhe shpresojmë të kthehemi në të ardhmen me punë të reja”, – Aktivist, “ART-Playback” Inclusive Theatre Association, Ukrainë

“FemArt ishte frymëzues, urgjent, dhe thellësisht me ndikim — ishte një nder të merrja pjesë si folëse dhe të përjetoja një program kaq të fuqishëm, veçanërisht shfaqjen teatrale “Jam Unë Ajo”. Na preku gjithashtu ngrohtësia dhe mikpritja në Prishtinë, dhe shpresojmë të kthehemi së shpejti.” – Women of the World, Sabeena Akhtar, Mbretëria e Bashkuar.

“Në bashkëpunim me FemArt, sollëm Shkodrën Elektronike, një ngjarje që i kushtohet Muajit të Çlirimit të Prishtinës. Kësaj here, festuam dashurinë e grave për dritën, atë dritë që ndriçon kujtesën, rezistencën dhe lirinë. Sepse nuk ka simbiozë më të fortë e më të qëndrueshme sesa dashuria për dritën e vendit dhe përkushtimi ndaj emancipimit”, Sibel Halimi, Drejtore e Kulturës në Komunën e Prishtinës.

MEDIAT PËR FEMART 13

“Në një mbrëmje që përçoi emocione, kujtesë kulturore dhe energji bashkëkohore, edicioni i 13-të i festivalit FemArt filloi me një performancë që kapërceu kufijtë e një koncerti tradicional”, - Flonja Haxhaj, Kultplus.

“Në një kohë kur zërat shpesh mbeten të burgosur në mendësi të vjetra, festivali feminist “FemArt” ka ardhur si një ftesë për t’i thyer heshtjet dhe për ta çliruar mendjen. Me moton “Çlirroje mendjen”, festivali feminist ndërkombëtar në edicionin e 13-të sjell përmes artit – në të gjitha format e tij – një thirrje për liri, barazi dhe imagjinatë të pakufishme. Në këtë hapësirë ku skena bëhet vend për rezistencë, reflektim dhe rritje kolektive, artistet dhe aktivistet nga vende të ndryshme kanë bashkuar forcat për ta riformësuar mënyrën si mendohet, ndihet dhe veprohet”, Sinan Berisha, KOHA.

“FemArt 13 mbyllet me një frymë kolektive rezistence, qartësie dhe krijimtarië – duke lënë pas kujtime të paharrueshme dhe një thirrje të fuqishme për barazi, drejtësi, shëndet mendor dhe dashuri” - Klan Kosova

CIRCLE FEST – EDICIONI I PARË



Circle Fest debutoi në Prishtinë si një festival pionier i arteve multidisiplinare, duke u pozicionuar që në edicionin e parë si një platformë e rëndësishme rajonale për dialog artistik, rrjetëzim dhe reflektim shoqëror. I mbajtur më 15 dhe 16 nëntor 2025, në Qendrën Kulturore Termokiss dhe në Teatrin Dodona, festivali mbledhi mbi 40 artistë, performues dhe veprimtarë kulturorë nga i gjithë Ballkani Perëndimor, përfshirë Kosovën, Serbinë, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Malin e Zi, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Slloveninë.

Misioni themelor i Circle Fest ishte të kultivonte dialog rajonal, të fuqizonte zërat e të rinjve dhe të demonstronte fuqinë transformuese të artit në ndërtimin e paqes, mirëkuptimit dhe unitetit shoqëror. Përmes një programi të kuruar me kujdes që përfshinte arte pamore, teatër, poezi, film dhe muzikë, festivali krijoi një hapësirë dinamike për bashkëpunim ndërkufitar, reflektim kritik dhe festim kolektiv të diversitetit artistik dhe njerëzor.

Vizioni i Circle Fest është themelimi i një platforme të qëndrueshme rajonale, ku arti shërben si katalizator për rrjetëzim, mirëkuptim të ndërsjellë dhe ndryshim pozitiv shoqëror, veçanërisht tek artistët e rinj. Duke mbledhur krijues nga fusha të ndryshme artistike, festivali synon të lehtësojë dialogun rreth sfidave të përbashkëta rajonale dhe aspiratave kolektive, duke ndërtuar ndjenjë solidariteti dhe qëllimi të përbashkët. Përmes shprehjes kreative, Circle Fest synon të sfidojë stereotipet e rrënjosura, të zërthejë ndarjet historike dhe të kontribuojë në ndërtimin e një narrative të re unifikuese, të bazuar në humanitetin e përbashkët.

Programimi i festivalit u ndërtua rreth temave të ndërlidhura si fragmentimi dhe tërësia, identiteti personal dhe kolektiv, shëndeti mendor, roli i të rinjve në shoqëri dhe arti si mjet për paqe. Këto tema u reflektuan në të gjitha format artistike, duke krijuar një mozaik përvojash që trajtonin realitetet e rajonit pas konfliktit dhe sfidat bashkëkohore të brezit të ri.

Dita e Parë – 15 Nëntor 2025

Festivali u hap zyrtarisht në Termokiss me një fjalim hyrës nga Zana Hoxha, drejtoreshë ekzekutive e Artpolisit, e cila theksoi rëndësinë e krijimit të një hapësire të përbashkët ku artistët e rinj nga rajoni mund të takohen, të rrjetëzohen dhe të ndajnë përvoja e ide. Circle Fest u prezantua jo thjesht si një ngjarje dyditore, por si fillimi i një platforme afatgjatë dialogu dhe bashkëpunimi.

Një nga aktivitetet qendrore të ditës së parë ishte ekspozita kolektive e arteve pamore “Individuals Fragments”, e kuruar nga Berat Bajrami. Ekspozita përfshiu punime nga 13 artistë të rinj nga rajoni, të realizuara në media të ndryshme si pikturë, video, instalacion dhe printim. Përmes konceptit të identitetit si proces i fragmentuar dhe jo-linear, ekspozita sfidoi idenë e tërësisë si përsosmëri, duke theksuar diversitetin si burim force dhe kuptimi. Ekspozita shërbeu si hapësirë reflektimi, dialogu dhe bashkëpunimi ndërkufitar.

Programi vazhdoi me sesionin e poezisë dhe diskutimit “Breaking Walls That Divide Us”, ku poetë nga Kosova, Serbia dhe Mali i Zi ndanë reflektime mbi dashurinë, humbjen, kujtesën dhe shpresën. Diskutimi nënvizoi rolin e poezisë si gjuhë universale që kapërcen kufijtë kombëtarë dhe krijon ndjeshmëri të përbashkët njerëzore.

Në mbrëmje u shfaq monodrama “No Surprise”, një performancë e fuqishme që trajtoi realitetet e të rinjve përballë presionit shoqëror, vetmisë dhe rraskapitjes emocionale. Programi filmik përfshiu shfaqjen e filmave “When the Dream Kills” dhe “Elvis Starling”, të pasuara nga diskutime të hapura me artistët, duke thelluar reflektimin mbi procesin krijues dhe temat e trajtuara.

Dita e parë u përmbyll me koncertin eksperimental jazz “Grey Heron” nga grupi AUM dhe një After Party energjike me DJ Yuko, duke e shndërruar hapësirën në një vend festimi, rrjetëzimi dhe bashkimi përmes muzikës dhe vallëzimit.



Dita e Dytë – 16 Nëntor 2025

Dita e dytë u hap me tryezën e rrumbullakët “When Art Becomes Peace: Stories of Change from the Balkans”, e moderuar nga Venera Ismaili. Diskutimi krijoi një hapësirë të sigurt për ndarjen e rrëfimeve personale mbi rolin e artit në ndërtimin e paqes, shërimin personal dhe dialogun ndërkufitar. Ky session përforcoi misionin e Circle Fest për ta shndërruar artin në mjet konkret të mirëkuptimit dhe lidhjes njerëzore.

Programi vazhdoi me koreodramën “7” nga Teatri Contra (Serbi), një performancë fizike dhe emocionale që trajtoi shëndetin mendor përmes lëvizjes bashkëkohore. Më pas, në Teatrin Dodona u shfaq shfaqja teatrale “La Macbeth”, një reinterpretim bashkëkohor i Shekspirit nga një perspektivë femërore, duke

demonstruar qasje inovative dhe eksperimentale në teatrin rajonal.

Festivali u përmbyll në mënyrë simbolike me koncertin energjik të grupit Mali Demon nga Serbia, i cili krijoi një përvojë katartike dhe emocionale për publikun, duke shënuar një fund të fuqishëm për edicionin e parë të Circle Fest.

Në përfundim, edicioni i parë i Circle Fest u dëshmuar si një platformë e suksesshme multidisiplinare që jo vetëm shfaq talentin e artistëve të rinj nga rajoni, por edhe ndërtoi ura dialogu, empatie dhe bashkëpunimi. Festivali vendosi themelet për një traditë të re kulturore në Prishtinë dhe në rajon, duke e afirmuar artin si gjuhë të përbashkët dhe si mjet për ndryshim shoqëror dhe ndërtim paqeje.



REZULTATET KRYESORE:

- **12 aktivitete të zbatuara me sukses gjatë festivalit.**
- **41 artist pjesëmarrës:** 26 femra, 15 meshkuj, që përfaqësojnë rajonin si më poshtë: Kosova – 13, Shqipëria-1, Serbia- 13, Bosnja dhe Hercegovin-1, Mali i Zi- 2, Maqedonia e Veriut-9, Sllovenia-2.
- **Arritja totale:** 611,711 njerëz në postimet në Facebook dhe Instagram.

PËRSHTYPJET E ARTISTËVE PËR CIRCLE FEST 1

“Jam shumë i lumtur që po prezantoj punimin tim në këtë festival, organizimi është vërtetë i mrekullueshëm dhe përzgjedhja e punimeve është vërtetë e larmishme, gjëja më e rëndësishme është që të gjitha punimet janë me cilësi të lartë, bashkëkohore dhe modern. Është ekspozitë e mrekullueshme, një mundësi e mirë për t’u njohur me artistët e tjerë. Deri tani kjo ka qenë një përvojë e mrekullueshme”. Milo Masonić nga Mali i zi

“Dua t’ju falenderoj për gjithçka!!! Për mirëpritjen fantastike, për këtë mundësi të mahnitshme të ekspozoj punimin tim në Circle Fest dhe për mundësi të shohim pakëz Prishtinën. Ishte me të vërtetë nder të ndaj punimin tim dhe përvojat së bashku me artistët e tjerë të mrekullueshëm dhe frymëzues. Jam shumë me fat që po shoh medime të ndryshme të ekspozuara në një ekspozitë. Shpresoj që në të ardhmen do të kemi festivale të tilla!! Gjithçka ka qenë e organizuar mirë dhe unë kam kaluar një kohë të paharruar.” Angelina Pajković nga Serbia.

“Është jashtëzakonisht e rëndësishme për mua që në festivale si ky, të takoj njerëz që mendojnë ndryshe nga unë dhe që i shprehin këto këndvështrime të ndryshme përmes veprave të tyre artistike. Prandaj, unë e vlerësoj veçanërisht këtë aspekt të bisedave, të dialogut që ne në Ballkan na pëlqen shumë – të diskutosh pse dikush shkroi një varg të të caktuar, pse dikush e bëri skulpturë kaltër ose një tjetër roze. Vetëm në këto pak orë që kam qenë këtu sot, kam mësuar kaq shumë për botën e tyre të brendshme dhe, nga ana tjetër për botën time. Jam shumë mirënjohëse që ekzistojnë mundësi të tilla dhe mezi pres të flas me artistët e tjerë në festival”, Amina Kaja nga Kosova.

“Pritshmëritë e mia për këtë festival ishin të larta, sikurse çdo gjë tjetër që Artpolisi e organizon, dhe po e përsëris edhe njëherë si çdo gjë tjetër nga Artpolisi ka qenë përvojë e mrekullueshme. Ishte vërtet interesante të shihja përvojat e artistëve dhe mënyrat që ata zgjedhën ta shprehin artin e tyre. Më bëjnë gjithmonë përshtypje ato pjesët e artit që artistët vendosin të zbulojnë përmes veprave të tyre. Sidomos gjatë këtyre dy ditëve të fundit, ky aspekt ka qenë shumë intensiv, por në përgjithësi, mendoj se festivali ka qenë i shkëlqyer. I inkurajoj të gjithë të vijnë vitin e ardhshëm dhe të ndjekin aktivitetet e Circle Fest.” Erblina Luma nga Kosova.

“Fillimisht, dua të them që jam shumë i befasuar nga nisma dhe trajtimin që e kam pasur këtu. Më pëlqen hapësira, dhe transformimi i hapësirës, prej një ndërtesë të vjetër në një galeri moderne, ku mund të mbahen ekspozita tematike, aktiviste dhe ngjarje muzikore. Më pëlqen idea e ndërlidhjes, bashkimit të njerëzve që jetojnë në këtë territor, përpjekja për t’i thyer paragjykimet dhe të mirëkuptojmë njëri-tjetrin. Jam i fasonuar me llojet e ndryshme të njerëzve që janë këtu. Pres njohje të reja, të mësojë shumë gjëra të reja për popujt fqinj, për kulturën e diversitetit në Kosovë, Maqedoni dhe vendet përreth. Mbi të gjitha, shpresoj të kaloj kohë të mirë, një performancë të shkëlqyer sonte dhe që njerëzit të përqafojnë muzikën tonë.” Dragan Teodosiev nga Maqedonia e Veriut.

“Mendoj që Artpolis përpjeket që të na bashkojë përtej kufinjëve. Ne kemi pasur privilegjin të dëgjojmë përvojat e njëra-tjetrës nga gratë e fuqishme të Serbisë dhe Kosovës. Por gjëja kryesore është që unë nuk kam folur asnjëherë më parë me një Serb dhe ishte atëherë mundësia kur pata privilegjin të flisja me ta dhe nuk kishte asgjë që na ndante dhe mendoj siç thatë ndërtimi i paqes përmes artit është e mundur dhe në fakt është gjëja e parë që mund të sjell paqe sepse politika është e vështirë të injorohet, por arti është diçka që na bashkon të gjithëve. Jemi këtu për shkak të artit.” Erblina Luma nga Kosova

“Ky festival dhe vendi ishte i mrekullueshëm. Kam takuar shumë njerëz nga komunitete të ndryshme, jemi angazhuar, kemi ndarë histori që mua më prekën shumë dhe shpresoj që kam përçuar të njejtën tek të gjithë. Pra, po, ju lutem ejani këtu nëse ju ofrohet mundësia dhe ta shfrytëzoni këtë mundësi. Më pëlqeu! Faleminderit të gjithëve” Hakan Daci nga Maqedonia e Veriut

“Është hera ime e parë në Prishtinë dhe duhet ta them që më pëlqeu këtu dhe duhet ta përmend në veçanti organizatorët e Circle Fest të cilët kanë qenë një nga organizatorët më të mirë që kam pasur. Kam qenë në shumë festivale dhe është mirëpritja më e madhe dhe e ngrohtë që kemi pasur dhe më pëlqen se si fokusi i vetëm është që artistat të komunikojnë, të shoqërohen. Ky definitivisht ishte rrjetëzimi më i madh që kam krijuar në një festival dhe ka kaq shumë njerëz të bukur dhe të talentuar këtu dhe më pëlqen dhe shpresoj që do të rikthehem prapë” Olga Kraljević from Serbia.

“Është mirë që ndodhem këtu në Prishtinë, është hera jonë e parë dhe organizimi deri tani ka qenë i mrekullueshëm. Deri më tani, gjëja ma e mirë për Circle Fest është që ne mund të takohemi me artistët e tjerë të flasim me ta rreth krijimeve artistike të tyre. Është shumë përfshirës, sepse të lejon të kuptosh nga vijnë njerëzit, cili është fusha e tyre dhe çfarë u mishërua në krijimet artistike që ata po shfaqin. Dhe një gjë tjetër është që më ka emocionuar shumë është se përzgjedhja e artistëve është fenomenale; siç duket gjithçka deri më tani, e dini, në stilin tonë. Pra, na pëlqen shumë deri tani. Shpresojmë të vijmë sërish.” Ilija Ivanović nga Serbia.

KRYESORET NGA MEDIAT PËR CIRCLE FEST 1

“Pa skena dhe pritshmëri madhështore, festivali “Circle Fest” synon të krijojë një model ku arti nuk kërkon të jetë i plotë, por vetëm i vërtetë në fragmentet që e përbëjnë atë.”, shkruan Sinan Berisha, KOHA.

“Edicioni i parë i festivalit “Circle Fest” ka nisur në Prishtinë duke sjellë një hapësirë ku arti nuk kërkon të jetë i përkryer, por i vërtetë në fragmentet që e ndërtojnë. I konceptuar si “nga artistët”, festivali synon të krijojë rrjete të reja bashkëpunimi midis krijuesve të rinj nga qytetet kryesore të Ballkanit, nga Beogradi e Podgorica, deri te Shkupi, Tirana dhe Prishtina.”, thotë Annamorea Tiara Nixha, ALBANIAN POST.

SHFAQJET TEATRORE PROFESIONALE DHE PERFORMANCAT

Artpolis ka vazhduar me angazhime të shumta artistike duke prezantuar shfaqje teatrore (përfshirë katër premiera), e performanca: “Kujtime nga Lumi – për Mance”, “Gratë e Trojës”, “Vojçeku”, “Shpirti”, “Prapa Ekrani”, si dhe një mbrëmje poetike “Poezi për Fuqi – Zë i revoltës së grave”.

SHFAQJA TEATRORE “VOJÇEKU”



Shfaqja “Vojçeku”, bashkëproduksion i Artpolis dhe Teatrit “Hadi Shehu” të Gjakovës, pati premierën më 21 shkurt 2025 në Gjakovë, duke shënuar një nga ngjarjet më të rëndësishme teatrore të vitit për Artpolis. Nën regjinë e Zana Hoxhës dhe adaptimin bashkëkohor të veprës së Georg Büchner nga Jack Thorne, shfaqja solli në skenë tragjedinë e individit të dehumanizuar, të shtypur nga dhuna sistematike, varfëria dhe mungesa e dinjitetit njerëzor.

Premiera u ndoq nga rreth 580 spektatorë, ndërsa reprizat e mbajtura më 5 dhe 12 mars si dhe më 20 maj 2025 në Teatrin “Hadi Shehu” u panë nga 220 shikues, duke dëshmuar interesim të vazhdueshëm të publikut për këtë rrëfim tronditës dhe reflektues. Shfaqja u rikthye sërish në skenën e Gjakovës më 13 nëntor, 2025, duke vazhduar dialogun me publikun mbi dhunën, shëndetin mendor dhe përgjegjësinë shoqërore.

Më 19 nëntor 2025, “Vojçeku” u prezantua në Teatrin e Gjilanit, ku u prit me emocione të forta dhe

vlërësime pozitive për qartësinë psikologjike të regjisë, lojën e fuqishme aktoriale dhe ndërtimin gradual të tensionit dramatik. Kritika theksoi mënyrën se si shfaqja shpalos me saktësi rrënimin moral dhe emocional të protagonistit, si pasojë e presionit ekonomik dhe dhunës së vazhdueshme.

Kulmin e rrugëtimit të vitit 2025, shfaqja e arriti më 23 nëntor, me pjesëmarrjen në Festivalin e Teatrit Shqiptar “Moisiu”, në Amfiteatrin e Teatrit Kombëtar të Kosovës. Aty, “Vojçeku” u vlerësua për qasjen e guximshme artistike, intensitetin estetik dhe fuqinë për të hapur reflektim mbi padrejtësitë shoqërore dhe traumën e individit në shoqërinë moderne.

Me lojën e aktorëve Bujar Ahmeti, Vlora Dervishi, Edi Kastrati, Aurita Agushi, Arbies Komoni, Altina Kusari dhe Eden Kastrati, si dhe me një skenografi të thjeshtë por domethënëse, drita udhërrëfyese dhe muzikë origjinale, “Vojçeku” u shndërrua në një përvojë teatrale të fuqishme që jo vetëm emocionon, por edhe fton në reflektim dhe dialog shoqëror.



artpolis



artpolis

POEZI PËR FUQI – ZË I REVOLTËS SË GRAVE



Foto: Rilind Beqa

“Mos u dorëzo, të lutem mos u lësho...
sepse ka ende zjarr shpirti,
dhe ëndrra gjallë ngeli.”

Këto vargje u bënë zemra e mbrëmjes poetike “Poezi për Fuqi”, një natë ku fjala u kthye në revoltë dhe poezia në akt rezistence. Ishte një revoltë kundër patriarkatit, kundër heshtjes dhe pabarazisë, kundër çdo forme shtypjeje që rëndon mbi trupin dhe zërin e grave.

Më 6 mars, në Menzën “Ramiz Sadiku”, artiste, aktiviste dhe poete u bashkuan në një frymë të përbashkët për të shënuar 8 Marsin jo me heshtje, por me revoltë poetike. Vargjet e Mario Benedettit, të interpretuara nga Alesia Xhemalaj, kumbuan si thirrje për të mos u dorëzuar kurrë, ndërsa poezitë e

interpretuara nga Ilire Zajmi, Bibi Qena, Rudina Dembacaj dhe Blerta Syla–Surroi sollën histori trupash, kujtese, zemërimi dhe force femërore.

Mbrëmja vazhdoi me një dialog të fuqishëm mes poezisë dhe muzikës, ku tingujt e Don’t Listen to Your Neighbors krijuan hapësirë emocionale mes vargjeve, duke e bërë revoltën të ndihej në çdo frymëmarrje të publikut.

Në skenë morën jetë edhe poezitë e Jacques Brel, Oriana Fallacit, Alda Merinit, Pablo Nerudës dhe Virginia Woolf, përmes interpretimeve të ndjera të Bislim Muçajt, Anisa Ismailit, Sheqerie Buçajt, Shpëtim Kastratit dhe Xhejlane Terbunjës. Poezia u shndërrua herë në dashuri, herë në dhimbje, herë në betejë të hapur për liri dhe dinjitet.

Kulmi i mbrëmjes solli një revoltë kolektive, ku çdo varg ishte një akt qëndrese. Interpretimet e Albulena Kryeziu Bokshit, Gili Hoxhajt, Jonada Jasharit, Zana Hoxhës dhe Vlora Ademit e shndërruan skenën në një hapësirë të përbashkët force, guximi dhe shprese.

Mikrofoni i hapur për publikun e çoi poezinë përtej skenës – në zërat e atyre që guxuan të flasin, në duart që ndanë vargje, në shpirtrat që u ndjenë pjesë e kësaj revolte.

Në fund të natës, nuk ishim më vetëm dëgjues. Ishim bashkë, në një fjalë të vetme: fuqi.

Poezia vazhdon të jetojë.
Revolta nuk ndalet këtu.



Foto: Rilind Beqa

SHFAQJA TEATRORE “SHPIRTI”



Mund të mos i kujtojmë, por a janë kujtimet që na mungojnë çelësi për të shëruar dhimbjet më të mëdha? Mund të mos i shohim, por a janë jetët e mëparshme pjesë e asaj që jemi sot? “Shpirti”, shfaqja që erdhi premierë më 30 prill, 2025 në Qendrën Barabar në Prishtinë, vuri përballë këto pyetje të thella me një qetësi poetike dhe një intensitet emocional që prek rrënjët e qenies njerëzore.

E bazuar në librin “Many Lives, Many Masters” të Dr. Brian Weiss – një psikiatër që sfidoi kufijtë e shkencës tradicionale për të zbuluar rrëfimet e shpirtit përtej kohës – shfaqja e regjisorit Agim Selimi ishte hapësirë reflektuese ku publiku ftohet të udhëtojë bashkë me Katerinën dhe Dr. Brianin, në një rrugëtim që është njëkohësisht shpirtëror dhe terapeutik.

Aktorët Albionë Sahiti dhe Drin Berisha, me një intensitet të përmbajtur, por gjithnjë të ndjeshëm, ndërton një dialog mes dy botëve – botës së dukshme dhe asaj që endet përtej logjikës. Sahiti, që portretizoi Katerinën me një ndjeshmëri të hollë, ishte në kërkim të çlirimit nga ankthi dhe depresioni. Ndërsa Berisha, në rolin e Dr. Brianit, mbart një përmbajtje intelektuale që gradualisht thyhet nga ajo që nuk mund të shpjegohet vetëm me shkencë – nga forca e padukshme e shpirtit dhe dashurisë.

Skenografia e thjeshtë dhe minimaliste nga Leonita Krasniqi shërbeu si një kornizë e hapur për imagjinatën dhe ndjeshmërinë. Një hapësirë gati-klinike, por që transformohej lehtësisht në peizazhe të brendshme, në ëndrra dhe kujtime që nuk kanë një vend të caktuar në kohë.

Në një kohë kur shëndeti mendor vazhdon të mbetet një temë shpesh e stigmatizuar, kjo shfaqje guxon të flasë për të, jo vetëm përmes termave klinike, por përmes gjuhës së zemrës, të kujtesës dhe të shpirtit. Në një botë të lodhur nga rrëfimet e sipërfaqshme, “Shpirti” rikujton fuqinë e tregimit të vërtetë – atë që

guxon të prekë plagët dhe të kërkojë shërim atje ku shpesh nuk guxojmë të shikojmë.

Kjo shfaqje u ndoq nga më shumë se 120 persona në audiencë.



SHFAQJA TEATRORE “KUJTIME NGA LUMI – PËR MANCE”



Foto: Yllka Fetahaj

Shfaqja “Kujtime nga Lumi” pati një prezantim të hapur për publikun më 26 korrik 2025 në Prishtinë, ndërsa premiera zyrtare u mbajt më 27 korrik. Një reprizë pasoi ditën tjetër, më 28 korrik. Më 30 korrik, lumi i kujtimeve rrjedhi përtej kufijve, duke mbërritur në skenën e Novi Sadit, ku u mirëprit si një udhëtim poetik mes artit dhe kujtesës.

Gjatë këtyre prezantimeve, mbi 180 pjesëmarrës përjetuan këtë ngjarje të veçantë teatrore.

Nëse fëmijëria është vendi ku formohet bota jonë e brendshme, atëherë “Kujtime nga Lumi” ishte një rikthim i guximshëm në këtë vend – të lumtur dhe të dhimbshëm njëkohësisht. Në këtë shfaqje eksperimentale, Zana Hoxha na ftoi të përballemi me atë që shpesh mundohemi ta harrojmë: zërin e padëgjuar të fëmijës brenda nesh.

Me një regji të thellë introspektive dhe një dramaturgjë që ndërthur poezinë me realitetin brutal,

shfaqja e vendosi publikun në një trajektore të ndjeshme – nga pafajësia tek dhuna e një shoqërie që nuk e përballon “të ndryshmen”. Mance – i portretizuar nga Edon Shileku – nuk ishte vetëm një karakter; ai ishte mishërimi i të gjithëve që janë ndërjerë të vegjël përballë përbuzjes, të talentuar por të shtypur, ëndërrimtar i nëpërkëmbur.

Hana (Qendresa Kajtazi) ishte kujtesa e gjallë e atyre që nuk janë më, bartëse e heshtur e dhimbjes, dëshmitare e pafuqisë për të shpëtuar mikun e saj. Në lojën e saj pati njëloj vuajtjeje të ngurtësuar, që e bëri dhimbjen akoma më të prekshme.

Shfaqja nisi tek Fontana e Pallatit të Rinisë, për të vazhduar në Burgun e Idealit – një udhëtim fizik që u bë metaforë për udhëtimin emocional. Kënga “E di se do të shohë” nga Minatori shoqëroi publikun si një himn i pashprehur i shpresës për të parë e për t’u parë.

Aktorët Elsa Belegu dhe Flamur Ahmeti – jo vetëm e plotësuan këtë rrëfim kolektiv, por sollën përmes trupit dhe zërit kujtesën që nuk hesht kurrë. Çdo skenë ishte një copëz e së vërtetës që shumëkush e mban fshehur. Nuk ishte vetëm struktura e saj eksperimentale që e bëri këtë shfaqje të veçantë, por mënyra se si ajo shndërrohet në një akt të përbashkët shërimi.

“Kujtime nga Lumi” nuk kërkoi vetëm të tregojë një histori – por ishte hapësirë e sigurt për reflektim,

për të ndjerë, për të qajtur dhe për të ndarë. Publiku nuk ishte vetëm spektaktor, ai u bë bashkëudhëtar e bashkërrëfyes. Teatri nuk ishte spektakël. Ishte terapi kolektive, e ballafaqim me veten.

Në një shoqëri që shpesh s’ka kohë të dëgjojë, “Kujtime nga Lumi” u bë dëgjim kolektiv. Dhe ky dëgjim, vetë, ishte një formë e shërimit dhe çlirimit nga pesha e së kaluarës.



SHFAQJA FORUM TEATËR “PRAPA EKCRANIT”



Foto: Yllka Fetahaj

Më 8 tetor 2025, në ambientet e Gjmnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë, u dha premiera e shfaqjes forum-teatër “Prapa Ekranit”, me dramaturgji dhe regji të Zana Hoxhës.

Ngjarjet u shpalesën brenda jetës universitare — një mikrokozmos ku studentët, përmes personazheve Krenarit, Dafinës, Leas, Ardit dhe profesoreshës Drita, përballen me trysinë e një bote të kontrolluar nga imazhet, pëlqimet dhe videot që imponojnë modele toksike të dashurisë, fuqisë dhe dëshirës.

Përmes Forum Teatrit, narrativat sollën një diskutim të gjallë ndërmjet personazheve dhe audiencës. Energjia e nxënësve gjatë debatit që pasoi ishte e dukshme — reagime të drejtpërdrejta, pyetje konkrete, përballje të sqarta me personazhet që simbolizonin figura reale të përditshmërisë.

Nxënësit nuk ishin spektatorë, por protagonistë të një kërkimi të përbashkët mbi kuptimin e dhunës

dhe manipulimit, duke shpërfaqur fytyrën e vërtetë të dhunuesve, e duke qëndruar në solidaritet me viktimat.

Në diskutim dolën në pah disa nga plagët më të thella të shoqërisë sonë digjitale: ngacmimet seksuale të normalizuara përmes ekraneve, ndikimi i thellë dhe i gjerë i dhunës online në jetën reale të njerëzve, fuqia e intelegjencës artificiale kur përdoret në kontekst negativ, format e manipulimit dhe të kontrollit në një lidhje që mbulohen nën petkun e “kujdesit”, dhe frika e kompleksiteti për të raportuar, sidomos kur përfshihet një person i afërt, e që në të shumtën e rasteve dhunuesit janë të afërm. “Prapa Ekranit” shërbeu pikërisht për demaskimin e kontrollit, dhunës dhe manipulimit.

Tre nga nxënësit e shkollës “Xhevdet Doda” u bënë pjesë e shfaqjes, duke rikrijuar skenat dhe ndryshuar narrativën. Pikërisht ky moment tregoi sërish

fuqinë e forum teatrit, që u vlerësua nga të rinjtë si një formë e fuqishme e edukimit dhe ndërtimit të vetëdijes, sepse ofron mundësinë e transformimit të menjëhershëm — jo vetëm në skenë, por edhe në vetëdijen e atyre që e përjetojnë.

“Prapa Ekranit” nuk ofroi përgjigje të lehta, por një thirrje të qartë për guxim — guximin për të raportuar e për të kundërshtuar secilën formë të dhunës e shtypjes. Ishte një reflektim mbi etikën e përgjegjësisë në kohën e algoritmeve dhe ndikuesve, një kujtesë se ndërgjegjja mbetet forma më e lartë e rezistencës njerëzore.

“Prapa Ekranit” u jetësua nga loja e aktorëve Ismail Kasumi, Qendresa Kajtazi, Anisa Ismaili, Edlir Gashi dhe Albana Gashi

Kjo shfaqje rrugëtoi në disa skena shkollore të Kosovës, si: në Kino “Jusuf Gërvalla” në Pejë më 21 tetor, në Gjimnazin “Kuvendi i Arbërit” në Ferizaj më 10 nëntor, në Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë më 19 nëntor, në Gjimnazin “Frang Bardhi” në Mitrovicë, më 3 dhjetor në kuadër të fushatës globale 16 Ditë e Aktivizmit kundër Dhunës në Bazë Gjinore dhe prezantimi i fundit për 2025 në Gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren më 17 dhjetor.

Përgjatë gjashtë prezantimeve rreth 348 persona ishin në audiencë.



SHFAQJA TEATRORE “KABARE 1999”



Foto: Rilind Beqa

Në nëntor nisi procesi i krijimit të shfaqjes “Kabare 1999” e cila mori formë deri në dhejtor 2025, sa zgjatën provat preliminare — një udhëtim teatror muzikor që lindi mes provave, kujtesës dhe skenës.

Premera dhe reprizat u dhanë në Teatrin e Gjilanit, në dhjetor 2025.

Një shfaqje teatrore muzikore e vendosur në Kosovën e pasluftës, ku kënga, humori i zi, ironia dhe kujtesa kolektive ndërthuren në një rrëfim të fuqishëm.

Nën regjinë e Zana Hoxhës, e frymëzuar nga “Cabaret”, rrëfimi zhvendoset nga Berlini i viteve '30 në Prishtinën e vitit 1999 – një qytet që po mëson të jetojë sërish, mes shpresës, lodhjes dhe etjes për jetë pas luftës.

Në qendër të shfaqjes është Aida, një vajzë që vjen në Prishtinë për të ndërtuar një të ardhme të

re. Ditën shkruan, ndërsa natën punon si bariste në “Klub Europa”, një kabare improvizuese ku realiteti dhe performanca përzihen, duke e futur atë në një trekëndësh dashurie dhe në kërkim të identitetit të saj.

“Kabare 1999” thellohet në kompleksitetin e Kosovës së pasluftës, duke ndriçuar betejat dhe triumfet e njerëzve që përpiqen të rindërtojnë jetën mes traumës dhe pasigurisë.

Provat po vazhdojnë me intensitet në skenën e Teatrit të Gjilanit, ku muzika, loja skenike, ironia dhe energjia e ansambllit po ndërtojnë çdo ditë një mozaik të gjallë artistik.

Çdo provë është një hap më afër një shfaqjeje që sfidon, emocionon dhe fton publikun të reflektojë mbi kohën, njeriun dhe shoqërinë.



PREZANTIME JASHTË VENDIT

Artpolis ka vazhduar me angazhime të shumta artistike duke prezantuar shfaqje teatrore edhe jashtë vendit, në rajon dhe Evropë, përfshirë prezantimet në Beograd dhe Lazarevc / Serbi, Lecce / Itali, Paris / Francë, me shfaqjet teatrore “Gratë e Trojës”, “Revoltë. Ajo tha. Revoltohu sërish.”

“KUJTIME NGA LUMI- PER MANCEN” NË NOVI SAD – PERFORMANCË DHE REFLEKTIM KOLEKTIV



Më 30 korrik 2025, performanca eksperimentale “Kujtime nga Lumi” u prezantua në Rusinski kulturni centar (RKC), duke sjellë përvojën e saj emocionale dhe reflektuese për publikun në Novi Sad, Serbi.

Pas prezantimeve në Prishtina (26–28 korrik), kjo vepe për me regji nga Zana Hoxha vazhdoi rrugëtimin e saj duke hapur hapësirë për reflektim mbi kujtesën, fëmijërinë dhe përjashtimin shoqëror.

Me interpretimet e Edon Shileku dhe Qendresa Kajtazi, performanca nuk ishte vetëm shfaqje, por një përjetim i përbashkët emocional.

Pas performancës, u zhvillua një diskutim i hapur me publikun, ku pjesëmarrësit ndanë reflektime mbi përvojat personale, traumën dhe rëndësinë e të dëgjuarit. Kjo e shndërroi performancën në një akt kolektiv dëgjimi dhe shërimi.

SHFAQJA TEATRORE “GRATË E TROJËS”



Shfaqja “Gratë e Trojës” ka vazhduar udhëtimin e saj ndërkombëtar gjatë vitit 2025, duke dëshmuar se tragjedia e lashtë e Euripidit mbetet një pasqyrë e gjallë e realitetit bashkëkohor të luftës dhe pasojave të saj mbi gratë.

Më 4 shtator 2025, shfaqja u prezantua në Lecce, Itali, në kuadër të Festivalit Tempora Contempora, ku përmes një qasjeje feministe dhe bashkëkohore, dhimbja e grave të Trojës u lidh drejtpërdrejt me plagët e luftërave moderne – nga Gaza dhe Ukraina, te Kosova, Somalia dhe Kongo. Regjia e Zana Hoxhës dhe Maja Mitić, me tekst bashkëkohor nga Shpëtim Selmani, e shndërroi skenën në hapësirë kujtese, rezistence dhe thirrjeje për paqe, duke prekur thellë publikun italian.

Udhëtimi vazhdoi në Serbi, më 29 dhe 30 nëntor 2025, me prezantime në Reflektor Theater Festival në Beograd dhe në Puls Teatar në Lazarevc. Prezantimet në Serbi u bënë në kuadër të fushatës globale 16 Ditë e Aktivizmit kundër Dhunës në Bazë Gjinore, ku këto shfaqje dëshmuar se Troja nuk është vetëm mit, por realitet i përhershëm i grave që jetojnë pas luftës, në mes të humbjes, shpërnguljes dhe dhunës.

Hekuba, Kasandra dhe Andromaka u shndërruan në zëra të grave të sotme, duke e bërë të dukshme barrën historike dhe emocionale që ato mbartin ndër breza.

Produksioni dygjuhësor, në shqip dhe serbisht, është fryt i një bashkëkrijimi dyvjeçar mes artistëve nga Kosova dhe Serbia: Maja Mitić, Shpëtim Selmani, Semira Latifi, Branka Stojković, Qëndresa Kajtazi, Labinot Raci dhe Aleksandar Stoimenovski. Ky bashkëpunim, ende i rrallë në kontekstin rajonal, e ka shndërruar shfaqjen në një akt artistik dhe politik të ndërtimit të besimit dhe dialogut.

Në Beograd, shfaqja u shoqërua edhe me një diskutim me publikun, ku u reflektua mbi procesin artistik, temat e trajtuara dhe sfidat e bashkëpunimit ndërkufitar. Publiku, rreth 210 persona në total, u largua i emocionuar dhe i vetëdijësuar se forca, qëndrueshmëria dhe dhimbja e grave nuk i përkasin së kaluarës – ato janë realitet që kërkon të dëgjohet sot.

“Gratë e Trojës” vazhdon të jetë më shumë se një shfaqje teatrore: është një udhëtim i përbashkët kujtese, rezistence dhe shprese për paqe.

SHFAQJA TEATRORE “REVOLTË. AJO THA. REVOLTOHU SËRISH.”



Më 19 shtator 2025, Artpolis prezantoi në Paris shfaqjen “Revolt. She Said. Revolt Again”, me regji të Zana Hoxhës, në kuadër të Festivalit WeToo, në Paris, Francë – një festival feminist, gjithëpërfshirës dhe inovativ. Para rreth 80 të pranishmëve, shfaqja u prit me reagime të fuqishme, duke hapur hapësirë për dialog e reflektim.

Me tekst të Alice Birch dhe interpretim nga aktoret Olive McHugh, Tanaka Mpofu, Xixi Xiao dhe Natalia May, shfaqja solli një përvojë teatrore intensive e provokuese, duke trajtuar tema mbi seksualitetin, pushtetin, punën dhe lirinë. Elementet vizuale, si skena e mbushur me shalqi, i dhanë dimension eko-feminist veprës, duke lidhur shtypjen patriarkale me shfrytëzimin e natyrës.

Siç shkruan Gili Hoxhaj, “Në rebelim nuk mjafton vetëm mendimi – të paktën jo për gratë e shekullit 21. Kjo është arsyeja pse shfaqja ‘Revolt. She Said. Revolt Again.’ i jep zë kësaj nevoje.”

Ky prezantim në Paris ishte më shumë se një shfaqje – një akt solidariteti që tejkalon kufijtë kombëtarë dhe sjell një gjuhë universale të barazisë dhe lirisë.

ARTIVIZMI FEMINIST

Arti dhe aktivizmi kanë vazhduar të jenë shtylla themelore të angazhimit të Artpolis në luftën kundër patriarkatit, dhunës me bazë gjinore dhe femicidit gjatë gjithë vitit 2025. Përmes protestave publike, marshimeve feministe, konferencave, performancave artistike dhe publikimeve kritike, Artpolis ka sfiduar hapur strukturat mizogjene dhe kulturën e heshtjes që normalizon dhunën ndaj grave. Këto veprime nuk kanë qenë vetëm reagim, por thirrje të vazhdueshme për drejtësi, përgjegjësi institucionale dhe ndryshim shoqëror, duke e kthyer artin në mjet rezistence dhe zërin feminist në forcë kolektive kundër vrasjeve të grave dhe çdo forme të shtypjes patriarkale.

MARSHOJMË S'FESTOJMË – MARSHUAM PËR NJËRA – TJETRËN



Më 8 Mars, rrugët e Prishtinës u mbushën me zemërim dhe solidaritet gjatë marshit tradicional “Marshojmë S’festojmë!”, organizuar nga Kolektivi “Marshojmë S’festojmë!”.

Këtë vit, marshuam për gratë që nuk janë më, për ato që heshtja dhe sistemi i kanë lënë në mëshirë të dhunës, për të gjitha ato që refuzojnë të dorëzohen. Nën moton “Marshojmë për njana-tjetrën”, qindra aktiviste, qytetare dhe qytetarë dolën në rrugët e Prishtinës për të kërkuar drejtësi dhe barazi për gratë e vajzat në Kosovë.

Në një vend ku vetëm gjatë vitit 2024 u raportuan 2,959 raste të dhunës në familje, ku gratë vriten nga burrat e tyre edhe brenda institucioneve që supozohet t’i mbrojnë, nuk ka asnjë arsye për festë.

Këtë vit marshuam për Erona Çoklin, e cila u vra brenda Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj; për Gjyljeta Ukellin, e cila u vra nga burri i saj në Pejë; për M.Zh., që u vra në Graçanicë, dhe për Sherife Tahirin, e cila u plagos rëndë nga burri i saj me pesë plumba, por

mbijetoi. Këto gra nuk janë më mes nesh sepse shteti dështoi t’i mbrojë, sepse sistemi gjyqësor vazhdon të falë dhunuesit dhe shoqëria vazhdon ta trajtojë dhunën si një çështje private.

Marshimi i 8 Marsit ishte një thirrje për drejtësi! Ishte një kundërshtim i hapur ndaj institucioneve që dështojnë t’i mbrojnë gratë, një revoltë kundër dhunës së normalizuar dhe një refuzim i heshtjes. Marshuam kundër lëvizjeve anti-gjinore, që përpiqen të zhbëjnë të drejtat e grave, kundër sistemit patriarkal që kërkon ta ruajë pushtetin mbi trupin dhe jetën e grave.

Ne marshuam për njana-tjetrën! Për një Kosovë ku gratë nuk rrezikojnë jetën brenda shtëpive të tyre, ku zëri i tyre dëgjohet dhe respektohet, ku dhuna nuk mbetet e pandëshkuar. Derisa ajo ditë të vijë, ne do të vazhdojmë të marshojmë, sepse nuk ka barazi pa luftë!

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE “ARTI + MENDJA: SHËRIMI, SHËNDETI MENDOR DHE BURNOUT NË REZISTENCËN KREATIVE”

Më 19 qershor, në kuadër të FemArt Festivalit, Teatri Kombëtar i Kosovës hapi dyert jo thjesht për një konferencë, por për një thirrje kolektive ndërgjegjësimi. Dita nisi jo me fjalime, por me këngë—zëra që u ngjitën lart nga Kori i Grave “Okarina”, nën drejtimin e Elikonë Hysaj Shalës. Interpretimi i tyre ishte më shumë se art; ishte një thirrje shpirtërore për çlirim.

Siç shkroi poetja dhe panelistja Shqipe Malushi, “Ato nuk erdhën vetëm si interpretoese, por si gra të shumë stinëve dhe qyteteve... Harmonia e tyre ishte më shumë se melodi—ishte balsam, frymëmarrje dhe urë”.

Kështu nisi Arti + Mendja: Shërimi, Shëndeti Mendor dhe Burnout në Rezistencën Kreative —një tubim ndërkombëtar me mbi 80 artiste feministe, profesioniste të shëndetit mendor, punëtore kulturore dhe aktiviste nga Kosova dhe rajoni. Së bashku, ato u përballën me tre urgjenca të ndërthurura: fuqinë shëruese të artit, krizën e shëndetit mendor në komunitetet krijuese dhe lodhja kronike e vazhdueshme që prek ata që gjenden në vijën e parë të rezistencës kulturore e shoqërore.

Me fjalën hyrëse nga Rita Glavitz e Agjencisë Austriake për Zhvillim, konferenca vendosi një ton kujdesi dhe qartësie. “Shërimi është një përgjegjësi e përbashkët,” tha ajo. “Dhe arti është lajmëtari më i sinqertë i tij”.

Konferenca u realizua përmes tri paneleve kryesore:

Paneli 1: Arti si Mjet Shërimi – Si Mund të Shërojmë Arti Shoqërorin?

Moderator: Arbër Selmani (Kosovë)

Panelistë: Ana Isakovic (Serbi), Zana Hoxha (Kosovë), Ilire Vinca (Kosovë), Janet Reineck (SHBA), Hanna Shestakova (Ukrainë)

Paneli 2: Si i Trajtojmë Çështjet e Shëndetit Mendor në Industrinë Kreative?

Moderatore: Edita Doli (Kosovë)



Panelistë: Sibel Halimi (Kosovë), Dr. Mariele Leclère (Francë), Maja Mitić (Serbi), Blerta Zeqiri (Kosovë), Linda Llulla Gashi (Kosovë)

Paneli 3: Lodhja kronike tek Artistet/ët dhe Aktivistet/ët

Moderatore: Andrijana Kočić (Serbi)

Panelistë: Sabina Akhtar (MB), Shqipe Malushi (SHBA/Kosovë), Rajmonda Sylbije (Kosovë), Adelina Berisha (Kosovë), Fatlinda Nitaj Rexhaj (Kosovë)

“Kjo nuk ishte thjesht një konferencë,” shkroi Malushi. “Ishte pasqyrë, balsam dhe çarje e murit të heshtjes. Panel pas paneli, histori pas historie—djetë e brendshme nuk u etiketua si dobësi, por si pasojë. E kujdesit. E dhënies. E ëndërrimit pa pushim.”

Konferenca ishte fillim, jo përfundim. Një hapësirë ku heshtja u thyer butësisht, ku dhimbja u takua me praninë, dhe ku shërimi, sado i ngadalshëm, u ndje i mundur. “Dhe kështu, u larguam jo të thyer, por të mbështetur. Jo bosh, por të zgjuar. Një kopsht shprese u mboll në ne — i rrënjosur në rezistencë, i ujitur me lot, dhe gati për të lulëzuar”, shkroi Malushi.

PANEL DISKUTIMI NË UP: UNIVERSITET I SIGURT NGA NGACMIMI SEKSUAL 2025–2026



Paneli i diskutimit “Studime të mbara dhe të sigurta: Universiteti i sigurt nga ngacmimi seksual 2025–2026” u mbajt më 29 shtator 2025, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, duke mbledhur mbi 25 pjesëmarrës të interesuar për të ardhmen e një hapësire akademike të lirë dhe të mbrojtur nga ngacmimi seksual.

Diskutimi u udhëhoq nga Zana Hoxha, aktiviste dhe regjisore teatri, e cila hapi rrugën për një dialog të hapur dhe interaktiv mes panelistëve dhe studentëve. Në vijim, Prof. Asoc. Dr. Majlinda Zhitija Gjelaj, Prodekane për Studime të Doktoraturës dhe Sigurim të Cilësisë, theksoi rëndësinë e rregullore për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual në UP, duke e vlerësuar si një arritje institucionale që duhet të shërbejë si shembull edhe për universitetet tjera. Ajo njoftoi studentët se tashmë ishte rishikuar Kodi i Etikës dhe se është në proces shqyrtimi edhe kjo rregullore sipas statutit të ri të universitetit. Ajo theksoi gjithashtu se së shpejti do të funksionalizo-

het Zyra e Ombudspersonit për studentë, një derë e re për mbrojtje dhe raportim.

Nga ana tjetër, Arjana Qosaj Mustafa solli perspektivën e shoqërisë civile, duke ndarë sfidat e përballura gjatë viteve dhe duke inkurajuar studentët që të informohen mirë mbi rregulloren dhe dispozitat ligjore, në mënyrë që të jenë të fuqizuar për të denoncuar rastet e ngacmimit. Liridona Osmanaj, ndërkaq, ndau përvoja të saj nga universitetet ndërkombëtare, ku praktikat institucionale në mbrojtjen e viktimave ishin më të konsoliduara, dhe i ftoi studentët që të qëndrojnë gjithmonë në solidaritet të plotë me viktimat.

Diskutimi u pasurua edhe nga pyetjet dhe kërkesat e studentëve, të cilët sugjeruan që periudha e raportimit të rasteve të ngacmimit të zgjatet nga një vit në pesë vite, duke reflektuar nevojën për ndryshime konkrete në rregullore.

16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE

Gjatë “16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore” (25 nëntor – 10 dhjetor 2025), Artpolis solli art dhe veprim në hapësira arsimore, kulturore dhe publike në Kosovë dhe rajon.

Fushata u hap me thirrjen “Du Studime, Pa Ngacmime” në Universitetin e Prishtinës, vijoi me dy prezantime të shfaqjes “Gratë e Trojës” në Serbi, shfaqjen “Prapa Ekranit” në Mitrovicë, shfaqjen forum teatër “A po m’nin” në Gjiilan, si dhe panelin e diskutimit “Du Studime Pa Ngacmime” në Universitetin e Prizrenit.

ARTPOLIS HAP “16 DITËT E AKTIVIZMIT” ME THIRRJEN PËR NJË UNIVERSITET PA NGACMIME



Me 25.11.2025 Artpolis ka nisur Fushatën Ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, duke vendosur në fokus studentët dhe hapësirën universitare. Me shpërndarjen e postereve informuese “Du Studime Pa Ngacmime” në 14 fakultete të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, kjo nismë shënon hapin e parë drejt një fushate që synon vetëdijësim, mbrojtje dhe veprim të përbashkët.

E realizuar në bashkëpunim me Uiversitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Parlamentin Studentor dhe me përkrahjen e UNFPA-së, kjo iniciativë informuese sjell më afër studentëve të gjitha informacionet rreth Rregullores për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimi Seksual dhe Ngacmimi në UP: çfarë konsiderohet ngacmim, si identifikohet, dhe cilat janë hapat e raportimit.

Për mediat Ekonomia Online dhe Kosovapress, Drilona Hamiti, asistente kreative në Artpolis dhe Kryetare e Parlamentit Studentor, theksoi se kjo formë informimi e bën procesin më të shpejtë, më të sigurt dhe më të qashtëm për çdo student, duke

forcuar angazhimin për një mjedis universitar të dinjitetshëm dhe pa ngacmime.

“Kjo iniciativë synon ta bëjë procesin e informimit dhe raportimit më të shpejtë, më të sigurt dhe më të arritshëm për secilin student, duke ofruar qasje të drejtpërdrejtë në të gjitha burimet e nevojshme. Artpolis dhe Parlamenti Studentor i UP mbeten të përkushtuar në krijimin e një mjedisi universitar të sigurt, të dinjitetshëm dhe pa ngacmime, duke vazhduar punën drejt fuqizimit të studentëve dhe përforcimit të mekanizmave të raportimit”, ka thënë ajo.

Ndërsa Ismet Krasniqi, Kryetar i organizatës studentore “Reforma”, nënvizoi rëndësinë e njohjes së Rregullores dhe lehtësimit të qasjes në këtë dokument si pjesë thelbësore për një universitet të sigurt.

Me këtë hap, Artpolis dhe partnerët e saj riafirmojnë përkushtimin për një universitet ku secili student ndihet i sigurt dhe i informuar drejtë duke rikujtuar se lufta kundër ngacmimit seksual fillon me ndërgjegjësim, transparencë dhe veprim.

PANELI I DISKUTIMIT “HAPËSIRA TË SIGURTA NË UNIVERSITETE: DU STUDIME PA NGACMIME”



Në përmbyllje të Fushatës Globale “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës në Bazë Gjinore” dhe në shënim të Ditës Botërore të të Drejtave të Njeriut, më 10 dhjetor 2025, Artpolis organizoi panel-diskutimin “Du Studime, Pa Ngacmime”, në bashkëpunim me Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe me mbështetjen e UNFPA-së.

Paneli u mbajt në amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik të UPZ-së dhe mbledhi gra profesioniste dhe aktiviste që ndajnë një vizion të përbashkët për universitete të sigurta, dinjitoze dhe pa ngacmime seksuale, përpara një audience të gjerë të përbërë nga studentë/e dhe staf akademik i Universitetit të Prizrenit.

Në panel morën pjesë: Prof. Asoc. Dr. Vjollca Dibra, Dr. Ariana Qosaj-Mustafa, Prof. Ass. Dr. Adelina Rakaj, znj. Tringa Kasemi dhe znj. Liridona Osmanaj, ndërsa diskutimi u moderua nga Venera Ismaili.

Biseda u fokusua në procesin e hartimit të rregullores kundër ngacmimeve seksuale, sfidat juridike

dhe institucionale, rolin e shoqërisë civile, si dhe domosdoshmërinë e ndërtimit të një kulture me zero tolerancë ndaj ngacmimeve seksuale në institucionet e arsimit të lartë.

Prof. Ass. Dr. Adelina Rakaj theksoi transparencën e procesit dhe rëndësinë e bashkëpunimit me Unionin Studentor: “Studentët kanë kontribuar dhe janë pjesë e këtij dokumenti.” Kjo qasje përfshirëse e studentëve është thelbësore për një proces të drejtë, demokratik dhe gjithëpërfshirës.

Dr. Ariana Qosaj-Mustafa ndau përvojën dhe sfidat e hartimit të rregullores në Universitetin e Prishtinës, duke vënë në pah rëndësinë e komponentëve normativë që garantojnë zbatim real, si dhe nevojën që rregulloret të përditësohen vazhdimisht, në përputhje me kërkesat e shoqërisë civile dhe studentëve. Ajo ofroi rekomandime konkrete për vazhdimin e trajnimeve, ngritjen e kapaciteteve dhe qartësimin e procedurave të raportimit.



Prof. Vjollca Dibra e përqendroi vëmendjen në dimensionin human të problemit: “Këtu flasim për trupin dhe dinjitetin tonë.” Ky theksim rikujton se çdo mekanizëm institucional duhet të ketë në qendër integritetin, sigurinë dhe mirëqenien e studentëve.

Liridona Osmanaj rikujtoi se ngacmimi seksual është “një problem multidimensional që kërkon zgjidhje multidimensionale”, duke përfshirë masa juridike, psikologjike, edukative dhe institucionale. Rregullorja, sipas saj, duhet të mbështetet në një qasje të plotë që përfshin parandalimin, edukimin, raportimin e sigurt dhe mekanizma të paanshëm hetimi.

Tringa Kasemi solli në panel dimensionin juridik dhe rolin kyç të shoqërisë civile, duke theksuar: “Sho-

qëria civile ka për obligim ta ngrejë zërin për ato/ata që nuk janë të fuqizuar.” Ajo nënvizoi se përkrahja dhe ndërmjetësimi nga organizatat e shoqërisë civile janë të domosdoshme për sigurinë e viktimave dhe qasjen e tyre në drejtësi.

Ky panel rikujtoi se ndërtimi i universiteteve pa ngacmime seksuale është një rrugëtim i gjatë, por i domosdoshëm, dhe se secila prej nesh ka një rol të qartë: të flasë, të raportojë, të avokojë, të edukojë dhe të veprojë. Vetëm përmes angazhimit feminist, bashkëpunimit të sinqertë dhe përgjegjësisë institucionale mund të sigurojmë që brezat e ardhshëm të studiojnë, punojnë dhe krijojnë në hapësira ku dhuna nuk ka vend.

AKTIVIZMI FEMINIST NË NDËRTIMIN E PAQES

Ndërtimi i paqes për Artpolis është një proces angazhimi i vazhdueshëm dhe i përditshëm. Në një kontekst rajonal të shënuar nga tensione të vazhdueshme dhe një paqe ende të brishtë në Ballkan, çdo veprim, iniciativë dhe bashkëpunim merr një rëndësi të veçantë në ruajtjen e stabilitetit dhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-etnike.

Gjatë vitit 2025, Artpolis, në bashkëpunim të ngushtë me organizata partnere nga rajoni, ka dhënë një kontribut domethënës në këtë drejtim përmes një sërë aktiviteteve artistike dhe edukative. Shfaqjet teatrale, punëtoritë, ligjëratat, trajnimet, iniciativat e përbashkëta dhe festivalet kanë shërbyer si platforma dialogu, reflektimi dhe ndërgjegjësimi, duke përdorur artin si mjet për ndërtimin e besimit, forcimin e solidaritetit dhe promovimin e një kulture paqeje dhe bashkëjetese.

INICIATIVA TË ANGAZHIMIT TË ALUMNI: FUQIZIMI I GRAVE TË REJA DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT FEMINIST NDËRKUFITAR



Iniciativat e Angazhimit të Alumni-ve 2025 shënojnë një kapitull të ri dhe të gjallë për Rrjetin e Alumni-ve të Shkollës Pranverore Feministe (FSS) — një kapitull i rrënjësor në motërzim, kreativitet dhe solidaritet ndërkufitar. Të mbështetura nga Kvinna till Kvinna, Artpolis lansoi një thirrje të hapur për të gjithë 56 alumnit, duke ftuar propozime të përbashkëta që vënë në qendër leadershipin feminist, lidhjen rajonale dhe aktivizmin afatgjatë. Tre nisma të guximshme u shfaqën, secila e prezantuar më tej gjatë fazës së dytë të Feminist Spring School.

Në zemër të këtyre Iniciativave qëndron angazhimi për të kultivuar bashkëpunimin midis grave të reja shqiptare dhe serbe — duke sfiduar narrativat e vjetra, ndërtuar besimin dhe riformësuar të ardhmen përmes vlerave feministe. Gjatë shkollës, pjesëmarrëset u angazhuan në diskutime mbi të drejtat e grave, kujtesën kolektive, paqen dhe barazinë, duke treguar se si tregimi i përbashkët dhe veprimi

i përbashkët mund të shpërbëjnë ndasitë dhe të frymëzojnë forma të reja të solidaritetit rajonal.

Tre propozime u zhvilluan në vitin 2025, dy prej të cilave u realizuan gjatë FemArt 13, brenda programit aktivist “Një Dhomë e Imja”: Sesioni i Shkrimit Performativ – “Gjenealogjia e Grave” dhe Diskutimi – “Çliro Vetën nga Barra Jote: Lidhu”, në partneritet me Qendrën Alternative të Vajzave (Kruševac), duke mbledhur 22 gra dhe burra të rinj në Hapësirën e Hamamit, Prishtinë:

- “Woman Start Up Accounting” – I udhëhequr nga Rrona Jaka dhe Sanja Krstić, kjo nismë mbështeti sipërmarrëset e reja në Kosovë përmes mentorimit të personalizuar online mbi kontabilitetin dhe menaxhimin financiar, duke i fuqizuar ato të forcojnë bizneset e tyre fillestare. Përfunduar në prill 2025.

- Sesiioni i Shkrimit Performativ – “Gjenealogjia e Grave” – Një eksplorim kreativ i kujtesës feministe, që ftoi pjesëmarrëset të shkruajnë për gratë që i kanë formësuar, duke rimarrë zëra të heshtur nën peshën e patriarkatit.
 - Diskutimi – “Çlirë Vetën nga Barra Jote: Lidhju” – Një hapësirë feministe e sigurt për të reflektuar mbi traumën ndërbreznore, realitetet e pasluftës dhe pritshmëritë e gjinore, duke nxitur empati dhe shërim kolektiv.
- Iniciativat e Angazhimit të Alumni-ve 2025 dëshmuar fuqinë transformuese të edukimit feminist dhe udhëheqjes së të rejave/rinjve. Duke mbështetur gratë e reja nga Kosova dhe Serbia në bashkë-krijimin e projekteve kuptimplota, Artpolis vazhdon të forcojë një lëvizje feministe të qëndrueshme e të ndërlidhur në Ballkanin Perëndimor — një lëvizje e rrënjësor në guxim, bashkëpunim dhe shpresë.



TAKIMI TRANSNACIONAL NË PRISHTINË – FORCIMI I PARTNERITETIT – PROJEKTI HOPE



Më 10 shkurt 2025, përfaqësuesit/et e organizatave partnere u mblodhën në ambientet e Artpolis në Prishtinë për një Takim Transnacional si pjesë e Projektit HOPE – Historia e Paqes për Edukim përmes Teatrit.

Në këtë takim morën pjesë Dah Teatar (Serbi) si partner kryesor, Action Synergy Sa (Greqi), Theatro Aeroploio – Ena Theatro Giapaidia (Greqi), Artpolis (Kosovë), World Vision (Bosnjë dhe Hercegovinë), dhe Fondacija za promovisanje nauke “Prona” (Mal i Zi).

Gjatë takimit, partnerët patën diskutime produktive mbi përparimin e projektit, planifikimin e aktiviteteve të ardhshme, periudhën e raportimit dhe strategjinë e rrjeteve sociale. Seanca ofroi një platformë të vlefshme për shkëmbimin e informacionit, forcimin e bashkëpunimit për realizimin e suksesshëm të objektivave të projektit.

“UNMASC! PUNËTORITË E KËRKIMIT ARTISTIK: EKSPLORIMI I DREJTËSISË GJINORE PËRMES TEATRIT”



Në kuadër të trajnimit “Edukimi i Bazuar në Teatër”, gjatë muajit mars 2025 u realizuan katër punëtori të Kërkimit Artistik në Ferizaj, Prishtinë dhe Pejë (më 2, 3, 19 dhe 23 mars). Të udhëhequra nga Berat Bajrami dhe Elira Lluka, këto punëtori krijuan hapësira reflektuese ku teatri u përdor si mjet për adresimin e padrejtësive gjinore dhe angazhimin shoqëror.

Si pjesë e projektit “Unmasc! Promovimi i Drejtësisë Gjinore përmes Teatrit të Angazhuar Shoqërisht”, 44 pjesëmarrës u përfshinë në ushtrime dinamike që ndërthurën lëvizjen, zërin dhe improvizimin për të eksploruar temat e shtypjes, rezistencës, pushtetit dhe harmonisë shoqërore.

Punëtoritë nisën me ushtrime ndërlidhëse për ndërtimin e besimit dhe identitetit kolektiv, ndërsa në qendër të procesit qëndruan teknika si “Skulptura e Ngrirë”, “Ushtrimi i Pasqyrës” dhe “Ecja në Hapësirë”, përmes të cilave pjesëmarrësit reflektuan mbi dinamikën e pushtetit dhe barazisë gjinore.

Përmes diskutimeve dhe reflektimeve finale, punëtoritë shërbyen jo vetëm si praktikë teatrore, por edhe si nxitje për aktivizëm feminist dhe veprim shoqëror, duke e shndërruar teatrin në një mjet të fuqishëm për drejtësi gjinore dhe ndryshim shoqëror.

ZËRAT E SHPRESËS: TË RINJTË NDËRTOJNË PAQEN PËRMES ARTIT NË PRISHTINË



Nga 10 deri më 13 shkurt 2025, Prishtina u bë një qendër e kreativitetit, dialogut dhe shkëmbimit kulturor, kur vizionarët e rinj nga e gjithë Ballkani u mblodhën për Trajnimin Ndërkombëtar të të Rinjtë.

Ky program transformues bashkoi artistë, aktivistë dhe edukatorë për të shqyrtuar fuqinë e artit në ndihmën e ndërtimit të paqes, duke nxitur lidhje përtej kufijve dhe duke formuar një të ardhme të mbështetur në unitet dhe mirëkuptim. Përmes punëtorive interaktive dhe diskutimeve, pjesëmarrësit angazhuan në një shkëmbim dinamik idesh dhe përvojash. Ata eksploruan se si tregimi i historive, teatri dhe artet vizuale mund të shërbejnë si mjete për pajtim, duke sfiduar narrativat e ndarjes dhe duke fuqizuar zërat e paqes.

Si pjesë e Projektit HOPE – Historia e Paqes për Edukim përmes Teatrit, pjesëmarrësit nisën një udhëtim kulturor në Prizren dhe Gjakovë në ditën e tretë të trajnimit, ku, nën udhëheqjen e Enes Toskës,

një udhërrëfyes profesionist, ata vizituan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Hamamin Gazi Mehmet Pasha, Muzeun Arkeologjik të Prizrenit, Kishën e Shën Mërisë së Ljevishkës, dhe Katedralen Katolike e Zojës Ndihmëtare, duke u zhytur në diversitetin historik, fetar dhe kulturor të Kosovës. Kjo përvojë e forcoi idenë se paqja ndërtohet përmes edukimit, dialogut dhe përvojave të përbashkëta, duke thelluar kuptimin e tyre për historinë komplekse të rajonit.

Gjatë trajnimit, liderët e rinj bashkëpunuan në projekte artistike që reflektonin vizionet e tyre për një të ardhme më paqësore. Ata krijuan pjesë të shfaqjeve teatrale dhe projekte të tregimit të historive multimediale, të gjitha të fokusuar rreth temave të pajtimit, bashkëjetesës dhe qëndrueshmërisë. Këto shprehje krijuese shërbyen si kujtesa të fuqishme se arti ka aftësinë të kalojë barrierat gjuhësore dhe politike, duke nxitur empatinë dhe lidhjen.

PUNËTORI MBI VLERËSIMIN E SHKOLLËS PRANVERORE FEMINISTE



Workshopi mbi Vlerësimin e Shkollës Pranverore Feministe, i mbajtur më 26–28 shkurt 2025 në Tiranë, mbledhi pjesëmarrëset nga dy organizatat partnere, Artpolis (Kosovë) dhe Qendra Alternative për Vajza (Serbi), me qëllim vlerësimin e efektivitetit, përfshirjes dhe ndikimit të edicioneve të deritanishme të programit Shkolla Pranverore Feministe (FSS), si dhe reflektimin mbi të ardhmen e kësaj iniciative transformuese.

Nën vlerësimin profesional të realizuar nga eksperte e jashtme (outsourcë) dhe përmes një procesi të facilituar dhe të udhëhequr profesionalisht, pjesëmarrëset u angazhuan në reflektime krijuese, analiza në grup dhe ushtrime vizionimi. Gjatë këtij procesi u identifikuan pikat e forta, sfidat dhe mundësitë kryesore për përmirësim, duke u theksuar roli i FSS si një hapësirë e rëndësishme solidariteti, fuqizimi dhe shkëmbimi feminist ndërkuftar.

E organizuar nga Artpolis dhe Qendra Alternative për Vajza, Shkolla u përshkrua nga pjesëmarrëset si frymëzuese dhe sfiduese, por me ndikim të thellë në nxitjen e ndërtimit të paqes, aktivizmit dhe të mësuarit feminist. Pavarësisht sfidave si financimi i

kufizuar, angazhimi i pabarabartë i pjesëmarrëseve dhe paqëndrueshmëria politike në rajon, përvoja u vlerësua si një udhëtim unik për të gjitha palët e përfshira – pjesëmarrëset, organizatorët dhe trajnerët – duke kontribuar në zhvillimin e aftësive të reja, ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe forcimin e solidaritetit feminist.

Gjatë procesit të vlerësimit, u reflektua edhe mbi përvojat dhe perceptimet e pjesëmarrëseve, të cilat e përshkruan FSS me shprehje si “një dritë në tunel”, “një hapësirë feministe dashurie dhe miqësie” dhe “fuqia e grave ndryshon botën”, duke e pozicionuar Shkollën Pranverore Feministe si një dëshmi të fuqishme të potencialit transformues të të mësuarit kolektiv dhe ndjekjes së paqes së qëndrueshme përmes vlerave feministe.

Pas punëtorisë, në kuadër të këtij procesi vlerësimi, u organizuan edhe fokus-grupe me pjesëmarrëset nga Kosova dhe Serbia, si dhe intervista me trajnerët e programit, përmes pyetësorëve dhe takimeve direkte, të gjitha të realizuara në kuadër të vlerësimit të jashtëm profesional.

TAKIMI I TRETË TRANSNACIONAL I PROJEKTIT UNMASC



Nga data 11 deri më 13 mars 2025, Prishtina mirëpriti takimin e tretë transnacional të projektit UNMASC, duke bashkuar tre partnerët; Artpolis (Kosovë), Kulturanova (Serbi) dhe Kulturhaus Brotfabrik (Austri). Ky takim strategjik shërbeu për të vlerësuar progresin, planifikimin e aktiviteteve të ardhshme dhe të forconte bashkëpunimin ndërkombëtar për promovimin e drejtësisë gjinore përmes teatrit dhe artit.

Takimi nisi me një prezantim të Artpolis dhe iniciativave aktuale të saj, duke u ofruar partnerëve një pasqyrë të detajuar mbi punën e organizatës në aktivizmin feminist përmes artit dhe prodhimit kulturor. Diskutimet u përqendruan në procesin krijues të shfaqjeve brenda kuadrit të UNMASC, ku partnerët përcaktuan logjistikën e turneve, përzgjedhën temat kyçe, finalizuan datat dhe përcaktuan hapat e nevojshëm për realizimin e produksioneve të ardhshme.

Një aspekt kyç i takimit ishte planifikimi dhe regjistrimi i podkasteve të lidhura me projektin, me qëllim

përhapjen më të gjerë të temave thelbësore të UNMASC dhe angazhimin e një audience më të gjerë. Partnerët u fokusuan gjithashtu në strategjitë e komunikimit, duke përfshirë përmirësimin e faqes zyrtare të UNMASC dhe zhvillimin e një e-Libri për të dokumentuar dhe shpërndarë njohuritë e fituara nga projekti. Këto iniciativa synojnë të sigurojnë qëndrueshmërinë dhe ndikimin afatgjatë të rezultateve të projektit.

Gjithashtu, partnerët ndanë përvojat e tyre mbi punën brenda kuadrit të Creative Europe dhe diskutuan praktikën më të mira për bashkëpunimin rajonal. Ky shkëmbim përvojash nxiti dialogun mbi mundësitë për bashkëpunime të ardhshme përtej UNMASC, duke forcuar rrjetet ndërkufitare të angazhuara për drejtësi gjinore në art.

Për më tepër, partnerët iu përkushtuan realizimit të detyrave të parashikuara për muajin mars, duke punuar individualisht për të siguruar përbushjen në kohë të objektivave të projektit.

Takimi Transnacional UNMASC në Prishtinë riafirmoi përkushtimin e të gjithë partnerëve për të përdorur teatrin si një mjet të fuqishëm avokimi dhe ndryshimi shoqëror. Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm

dhe inovacionit, projekti mbetet i dedikuar në çrrënjosjen e pabarazive gjinore dhe krijimit të hapësirave artistike gjithëpërfshirëse në mbarë Evropën.



THYERJA E BARRIERAVE: PUNËTORIA MBI BARAZINË GJINORE NË PRODUKSIONET ARTISTIKE



Më 13 mars 2025, Zana Hoxha udhëhoqi punëtorinë “Barazia Gjinore në Produksionet Artistike”, me pjesëmarrjen e 16 artistëve dhe profesionistëve nga fusha të ndryshme kulturore. Pjesë e këtij trajnimi ishin edhe anëtarë të organizatave partnere të projektit UNMASC, Kulturhaus Brotfabric/Austri dhe Kulturanova/Serbi, duke i dhënë punëtorisë një dimension të rëndësishëm ndërkombëtar dhe duke forcuar bashkëpunimet rajonale në funksion të ndërtimit të paqes.

Punëtorja u fokusua në analizimin kritik të barrierave strukturore, pabarazive gjinore dhe marrëdhënieve të pushtetit në industrinë kreative. Përmes prezan-

timeve, punës në grupe, ushtrimeve interaktive dhe improvizimeve teatrore, pjesëmarrësit reflektuan mbi sfidat me të cilat përballen gratë dhe grupet e marginalizuara, si dhe mbi strategjitë feministe për krijimin e hapësirave më gjithëpërfshirëse në art dhe kulturë.

Ky aktivitet nxiti dialog të hapur, solidaritet dhe shkëmbim përvojash ndërmjet aktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësisimit, fuqizimin profesional dhe ndërtimin e urave të bashkëpunimit për paqe dhe barazi gjinore.

TEATRI SI KATALIZATOR NË NDËRTIMIN E PAQES: TRAJNIMET LOKALE ME TË RINJ NË KOSOVË



Teatri ka qenë gjithmonë një hapësirë ku bisedat e vështira marrin jetë, ku zërat fuqizohen dhe ku komunitetet imagjinojnë të ardhme të reja. Përmes trajnimit “Edukimi i Bazuar në Teatër”, më 19 dhe 23 mars, 2025, në Ferizaj, Prishtinë dhe Pejë, u zhvilluan tri trajnime me të rinj, të udhëhequra nga Berat Bajrami dhe Elira Lluka. Këto sesione u shndërruan në një udhëtim përmes së cilit pjesëmarrësit eksploruan fuqinë e teatrit si mjet për dialog, shërim dhe ndryshim shoqëror.

Si pjesë e projektit “HOPE – History of Peace for Education through Theatre”, këto trajnime vendosën teatrin në zemër të përpjekjeve për ndërtimin e paqes, duke u dhënë të rinjve një platformë për të shprehur, sfiduar dhe ripërfytyruar realitetin e tyre.

Përmes ushtrimeve interaktive, 50 pjesëmarrës u angazhuan në një proces zbulimi—duke mësuar të përdorin trupin, zërin dhe rrëfimin kolektiv për të eksploruar zgjidhjen e konflikteve, pajtimin dhe drejtësinë. Duke hyrë në role dhe skenarë të ndryshëm, ata kultivuan ndjeshmëri, sfiduan paragjykimet dhe imagjinuan rrugë të reja drejt paqes.

Sesioni nisi me ushtrime themelore për të ndërtuar besim dhe bashkëpunim. “Thyrja e Akullit” dhe “Gjestet me emra” ndihmuan në krijimin e lidhjeve mes pjesëmarrësve, ndërsa aktivitetet e lëvizjes në grup i inkurajuan ata të ishin më të hapur dhe të ndjeshëm ndaj njëri-tjetrit. Këto ushtrime përgatitën terrenin për angazhim të thellë me temat më komplekse.

Në “Ushtrimin e Skulpturës”, pjesëmarrësit përfaqësuan fizikisht koncepte si dhuna, shtypja dhe ndërtimi i paqes, duke reflektuar mbi dinamikën e pushtetit dhe përgjegjësinë shoqërore. Duke ngrirë në poza që simbolizonin padrejtësinë dhe harmoninë, ata analizuan forcat që formësojnë botën e tyre dhe rolin e tyre në transformim.

Ndërkohë, “Ushtrimi i Pasqyrës” demonstroi rëndësinë e bashkëpunimit. Teksa partnerët imitonin lëvizjet e njëri-tjetrit, ata mësuan të udhëhiqnin dhe të ndiqnin me vetëdije—duke zbuluar se si ekuilibri dhe respekti i ndërsjellë janë thelbësorë, si në teatër, ashtu edhe në ndërtimin e paqes.

“KULTURA PA KUFË – NXITJA E DIALOGUT PËRMES ARTIT DHE KULTURËS”



Programi “Akullthyesit: Kultura Pa Kufij” implementuar nga organizata partnere Helsinki Committee for Human Rights from Serbia dhe në bashkëpunim me Artpolis, mbledhi së bashku artiste/ë, aktiviste/ë dhe intelektuale/ë nga Beogradi dhe Prishtina për të nxitur dialogun dhe shkëmbimin ndër-kulturor. Tetëmbëdhjetë pjesëmarrës/e nga Kosova dhe Serbia patën rastin të takohen dhe diskutojnë mbi të kaluarën, ndërtimin e paqes dhe pajtimin nga 20 deri më 30 mars, 2025 duke përjetuar së bashku përvoja të ndryshme gjatë vizitave të institucioneve kulturore në disa qytete të të dy vendeve fqinje dhe duke qenë pjesëmarrës në punëtoritë të udhëhequra nga mentorja Tamara Tomasheviq.

Në Beograd, përveç punëtorisë me Aleksandar Pavlović, pjesëmarrësit vizituan Qendrën për Dekontaminim Kulturor (CZKD), një qendër e mendimit kritik dhe rezistencës, ku eksploruan kulturën si mjet për ndryshim dhe Muzeun e Artit Bashkëkohor.

Programi përfshiu gjithashtu një vizitë në Kalanë e Petrovaradinit në Novi Sad, ku pjesëmarrësit ndoqën ekspozitën “Mileva: Ne Jemi Shkëmb”, e cila rishikon trashëgiminë e Mileva Marić Einstein dhe simbolikën e emrit Einstein. Në Novi Sad, Aleksandra Bosnić Đurić përmes temës “Refuzimi dhe kultura e rezistencës në një shoqëri të mbyllur” trajtoi situatën politike dhe protestat e studentëve në Serbi duke mos harruar edhe kujtesën kolektive për të kaluarën e luftës në Kosovë.

Në “Shtëpinë e të Drejtave të Njeriut” Sonja Biserko nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, e mirëpriti mysafirët, duke eksploruar marrëdhëniet në zhvillim mes Prishtinës dhe Beogradit dhe rolin e shoqërisë civile në forcimin e mirëkuptimit.

Vizita studimore në Serbi përfundoi me një diskutim me shkrimtarin Saša Ilić, i cili reflektoi mbi vizitën e

tij të parë në Prishtinë, rëndësinë e shkëmbimit kulturor dhe rolin e letërsisë në formësimin e perceptimeve.

Në Prishtinë, pjesëmarrësit u njohën me Artpolis, një organizatë që përdor artin dhe aktivizmin për të promovuar ndryshime shoqërore dhe barazi gjinore. Zana Hoxha ndau njohuri mbi punën e tyre, duke theksuar rolin e teatrit në fuqizim.

Ata vizituan gjithashtu Termokiss, një qendër kulturore e pavarur që nxit dialogun dhe ndryshimin e drejtuar nga komuniteti. Një punëtori me Igo Rugovën ofroi perspektiva mbi aktivizmin dhe ndërtimin e paqes, duke theksuar sfidat e pajtimit dhe rolin e grave në nxitjen e dialogut. Më pas, pjesëmarrësit vizituan Qendrën e Dokumentimit, ekspozitën “Na ishte njëherë që kurrë mos qoftë”, që nderon 1133 fëmijë të vrarë dhe të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ndërkaq, ligjerata e Blerta Bashollit, dramaturge dhe regjisore me nam e filmit, motivoi të rinjt/rejat që pavarësisht sfidave dhe vështirësive, këmbëngulësia për të ndjekur ëndrrën shpërblehet me sukses.

Në Prizren, në qytetin me diversitet kulturor, pjesëmarrësit vizituan Lidhjen e Prizrenit, një vend historik me rëndësi të madhe për identitetin kombëtar shqiptar. Bashkim Fazliu mbajti një ligjëratë mbi kombet, identitetet dhe mitet historike, duke nxitur diskutime mbi mënyrën se si narrativat historike formësojnë marrëdhëniet në Ballkan dhe mënyrat për të nxitur dialogun në vend të ndasive. Dokufesti, Lumbardhi dhe Kalaja e Prizrenit ishin pikat ku të rinjt/rejat kaluan kohë për të kuptuar rreth aktiviteteve dhe trashëgmisë kulturore të Prizrenit.

Dita e dhjetë e këtij shkëmbimi kulturor u kurorëzua me vizitën në Pejë, në kinemanë “Jusuf Gërvalla” për të dëgjuar dhe përcjellur disa animacione të shkurta nga ‘Anibar’ dhe më pas vizita në Manastirin e Deçanit dhe Patriarkanën e Pejës.

I gjithë ky rrugëtim, u përcjell dhe u kurua me kujdes nga mentorja e programit Tamara Tomasheviq, e cila i trajtoi të gjitha temat dhe diskutimet përmes artit duke inicuar ide kreative nga pjesëmarrësit/et e programit.



FORMËSIMI I RRËFIMEVE TË PAQES: PUNËTORIA NDËRKOMBËTARE PËR TË RINJTË NË SARAJEVË



Nga 7 deri më 10 prill 2025, Sarajeva – qyteti ku historia dhe shpresa bashkëjetojnë – u shndërrua në një qendër të gjallë të takimit ndërkulturor për të rinjtë, artin dhe paqen. Në kuadër të projektit “HOPE – Historia e Paqes për Edukim përmes Teatrit”, 28 pjesëmarrës nga rajoni, përfshirë 19 të rinj plot energji dhe vizion, morën pjesë në një trajnim ndërkombëtar gjithëpërfshirës dhe transformues. Kjo nisimë kreative, e financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit Erasmus+, krijoi ura të reja bashkëpunimi përtej kufijve dhe përtej gjuhëve, duke sjellë së bashku njerëz, rrëfime dhe shpresë.

Trajnimi bashkoi gjashtë organizata dhe institucione kulturore nga Ballkani: World Vision (Bosnjë dhe Hercegovinë), Dah Teatar (Serbi) si partner udhëheqës, Action Synergy Sa (Greqi), Teatro Aeroploio – Ena Teatro Giapaidia (Greqi), Artpolis (Kosovë) dhe Fondacija za promovisanje nauke “Prona” (Mali i Zi).

Nën udhëheqjen e një ekipi të përkushtuar mentorësh – Arman Beslija, Dijana Mitrović, Aggeliki Konstantopoulou, Elira Lluka, Alexandros Diamantis Balaskas, Berat Bajrami dhe Jasmina Bigović – pjesëmarrësit u përfshinë në një proces të thellë eksplorimi përmes metodave të teatrit, tregimit dhe dialogut ndërpersonal. Çdo ditë solli hapësira për reflektim, krijimtari dhe bashkëpunim, duke ndërtuar një komunitet të vogël që frymonte përmes artit dhe synonte paqen.

Në zemër të projektit HOPE qëndron bindja se teatri është më shumë sesa skenë – është një formë edukimi, një mjet për pajtim, dhe një gjuhë universale për ndërtimin e paqes. Përmes temave si kujtesa, identiteti dhe pajtimi, pjesëmarrësit guxuan të hapin rrugë të reja kuptimi dhe bashkëjetese. Sarajeva, me historinë e saj të dhimbshme por edhe të qëndrueshme, u shndërrua në një skenë ku zëri i të rinjve rezonoi fuqishëm.

Gjatë katër ditëve intensive, të rinjtë nuk ishin vetëm nxënës – ata u bënë aktorë të ndryshimit. Ata rrëfyan, dëgjuan, ndërtuan e guxuan. E sfiduan frikën dhe paragjykimin, e përqafuluan ndjeshmërinë dhe e shpalosën potencialin e madh që arti dhe edukimi kanë në proceset e pajtimit dhe bashkëpunimit rajonal.

Ky trajnim në Sarajevë nuk ishte vetëm një aktivitet. Ishte një fillim i ri. Një lëvizje e udhëhequr nga të rinjtë që e shohin të ardhmen me sy të hapur dhe zemër të gatshme për ndryshim. Në çdo skenë të luajtur, në çdo fjalë të thënë, ata dëshmuuan se paqja nuk është thjesht një ëndërr – është një zgjedhje, një praktikë e përditshme, një premtim që merret me përkushtim, dhe Sarajeva u bë dëshmitare e kësaj shprese të gjallë.

TAKIMI I TRETË TRANSNACIONAL NË SARAJEVË



Më 8 prill 2025, përfaqësuesit/et e organizatave partnere u mblodhën në Hotel Ibis në Sarajevë për takimin e tretë transnacional dhe të fundit *live*, në kuadër të projektit HOPE – Historia e Paqes për Edukim përmes Teatrit.

Në takim morën pjesë partnerët e projektit: Dah Teatar (Serbi) si partner kryesor, Action Synergy SA dhe Theatro Aeroploio – Ena Theatro Giapaidia (Greqi), Artpolis (Kosovë), World Vision (Bosnjë dhe Hercegovinë), si dhe Fondacija za promovisanje nauke “Prona” (Mal i Zi).

Gjatë takimit u diskutua mbi ecurinë e projektit, finalizimin e raporteve, aktivitetet e ardhshme të tra-

jnit, konferencat online dhe zhvillimin e platformës MOOC. Takimi shërbeu gjithashtu për forcimin e partneriteteve ndërmjet organizatave, si dhe për shkëmbim përvojash në një frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi.

Partnerët shfrytëzuan këtë rast edhe për të vizituar qytetin e vjetër dhe trashëgiminë kulturore të Sarajevës, duke thelluar më tej lidhjen mes kontekstit historik, kujtesës kolektive dhe vlerave të paqes që projekti HOPE synon të promovojë.

SHFAQJA TEATRORE “DREAM ON”



Më 28.04.2025, në skenën e Teatrit Oda në Prishtinë, Artpolis prezantoi premierën e shfaqjes “Dream On”, me regji nga Danilo Jovanović (Kulturhaus Brotfabrik), prodhuar në kuadër të projektit “UNMASC – promovimi i drejtësisë gjinore përmes teatrit”, me mbështetjen e BE-së dhe BMKÖS.

Shfaqja ndërthur ironi, emocione të shtypura dhe dhunën sistematike të patriarkatit ndaj grave. “Dream On” depërton në përvojën e grave në shoqëri, duke zbërthyer presionin për të qenë “e butë”, “e sjellshme”, “e bukur” dhe “jo shumë emocionale”. Që nga fillimi, publiku përballet me një klimë të ngarkuar emocionale – jo përmes dramatizimit, por përmes një sinqeriteti të zhveshur nga mburojat që gratë shpesh detyrohen të mbajnë. Fraza si “Pse po qan aq shumë?” apo “Shumë po e dramatizon!” përdoren për të demaskuar përqeshjen dhe shtypjen e emocioneve të grave, me pasoja të thella në mirëqenien e tyre mendore.

Në një strukturë fragmentare e poetike, aktoret Helena Araújo dhe Diana Stecker lëvizin mes euforisë së rreme të rrjeteve sociale – ku ndjekja e bukurisë

ideale dhe “pëlqimeve” kthehet në obsesion – dhe përpjekjes së një vaje për t’u bërë si shoqja e saj “e bukur dhe e famshme”. Kjo dëshirë për të qenë e pranueshme sipas standardeve të jashtme e çon trupin dhe mendjen drejt rrënimit.

Momente të tjera ndërpritën nga zëra mashkullorë që shpërfaqin kontrollin dhe dhunën psikologjike: “Unë jam burri në jetën tënde!” – fjali groteske, por fatkeqësisht të njohura. Regjisori e vendos në qendër shtypjen e përditshme që shumë gra përjetojnë, shpesh të maskuar si dashuri apo kujdes.

Shfaqja kulmon me një sekuencë dokumentare ku paraqiten statistika tronditëse mbi femicidin, duke e kthyer “ëndrrën” në një zgjim të dhimbshëm nga romantizimi, manipulimi emocional dhe dhuna sistematike.

“Dream On” nuk ofron përgjigje të lehta, por lë pyetje të hapura. Me një estetikë të thjeshtë, humor të errët dhe fragmente poetike, ajo bëhet pasqyrë e mënyrës si shoqëria e shtyp gruan – nga pritjet për butësi deri te heshtja vdekjeprurëse e femicidit.

SHKOLLA PRANVERORE FEMINISTE



Edicioni i sivjetëm i Shkollës Pranverore Feministe mbledhi së bashku 19 gra të reja nga Kosova dhe Serbia, në një hapësirë të sigurt, të hapur për dialog dhe ndërtim të urave ndërmjet komuniteteve – në zemër të natyrës së Brezovicës, nga 9 deri më 12 maj 2025.

Gjatë këtyre katër ditëve intensive, pjesëmarrëset patën mundësinë të angazhohen në ligjërata, punëtori dhe diskutime të thella mbi feminizmin, paqen, të drejtat e njeriut, median, artin dhe ndërseksionalitetin, me aktiviste feministe, lidere frymëzuese nga vendi dhe rajoni: Nevenka Rikalo, Xheni Karaj, Zana Hoxha, Tamara Tomasheviq, Resmija Rahman (Biba May), Jeta Xharra, Mary Ann Hennessey.

Temat që u trajtuan ishin, “Ne ndërtojmë ura miqësie”, “Interseksionaliteti mes LGBTI+ dhe lëvizjes feministe në Shqipëri”, “Nga paragjykimi të miqësia”, Dokumentari “Biba May-Jo Më”, “Thyerja e stereotipeve dhe demaskimi i lajmeve të rreme”, “Feminizmi është personal dhe politik”, deri të “Përmes artit dhe aktivizmit – promovimi i ndërtimit të paqes, diversitetit dhe barazisë gjinore”, ku edhe pjesëmarrëset

patën rast që të improvizojnë skena teatrore përmes ushtrimeve praktike me Zana Hoxhen.

Organizatorët e Shkollës Pranverore Feministe, nga Artpolis (Kosovë) dhe Qendra Alternative për Vajzat (Serbi) para pjesëmarrëseve shpalosën mundësitë e bashkëpunimit dhe vazhimit të aktivizmit edhe pas përfundimit të shkollës, përmes Rrjetit Alumni dhe projektit “Iniciativat e Përbashkëta”.

Atmosfera e hapur dhe bashkëpunuese, e mbështetur nga natyra dhe fryma e solidaritetit, krijoi një hapësirë unike për të reflektuar mbi sfidat dhe mundësitë që prekin vajzat dhe gratë e reja në rajon. Pjesë e këtij udhëtimi feminist ishte edhe vizita në qytetin e Prizrenit, ku pjesëmarrëset patën mundësinë të vizitojnë institucionet kulturore dhe të relaksohen përgjatë lumit, në zemër të qytetit të vjetër me diversitet të pasur kulturor.

Në fund, ceremonia e ndarjes së certifikatave dhe zbulimi i “mikes sekrete” shënuan përmbylljen simbolike të këtij kapitulli edukativ dhe transformues.

DIALOGË TË TË RINJVE NGA KOSOVA DHE SERBIA - SHKËMBIM NDËRKUFITAR KULTUROR NË FEMART



Nga 18 deri më 22 qershor 2025, Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet organizoi një shkëmbim ndërkufitar kulturor në kuadër të edicionit të 13-të të Festivalit FemArt në Prishtinë. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Kultura për Ndryshim: Drejt Marrëdhënieve më të Mira midis Serbisë dhe Kosovës përmes Artit dhe Aktivizmit të të Rinjve/Rejave”, në partneritet me organizatën nga Beogradi Helsinki Committee for Human Rights in Serbia.

Aktiviteti mbledhi 17 të rinj/e nga Kosova dhe Serbia, duke krijuar një hapësirë falas për dialog ndërkulturor, mirëkuptim të ndërsjellë dhe bashkëpunim krijues përmes artit dhe aktivizmit feminist.

Pjesëmarrësit/et u përzgjedhën përmes një thirrjeje të hapur dhe u përfshinë plotësisht në programin e Festivalit FemArt, duke marrë pjesë në punëtori, shfaqje artistike, diskutime dhe aktivitete rrjetëzimi. Përmes sesioneve interaktive dhe dialogëve të le-

htësuar, ata/ato trajtuan tema si identiteti, barazia gjinore, shëndeti mendor, ndërtimi i paqes, konflikti dhe kujdesi për komunitetin, duke bashkëpunuar ngushtë me artistë/e dhe punëtorë/e kulturorë nga rajoni dhe më gjerë.

Një element i veçantë i këtij shkëmbimi ishte Sfida në Instagram, përmes së cilës pjesëmarrësit/et ndanë reflektime të përditshme në formë fotografish, videosh dhe tekstesh të shkurtra. Ky aktivitet krijues forcoi zërat e të rinjve, nxiti dialogun ndërkulturor online dhe rezultoi në një thirrje kolektive për paqe dhe bashkëpunim.

Në tërësi, ky shkëmbim u mundësoi të rinjve shqiptarë dhe serbë të lidhen përtej kufijve, të reflektojnë mbi vlera të përbashkëta dhe të përjetojnë fuqinë transformuese të artit si mjet për ndryshim shoqëror, solidaritet dhe paqe.

UNMASC! NË FEMART 13: PREZANTIMI I PROJEKTIT DHE NJFOFTIM PËR PREMIERËN E ARDHSHME



Gjatë edicionit të 13-të të Festivalit FEMART, të mbajtur në Prishtinë, menaxherja e projektit në Artpolis dhe Projektin UNMASC!, Venera Ismaili, prezantoi një fletushkë që i prezantonte audiencës objektivat dhe arritjet kryesore të iniciativës UNMASC!. Ky prezantim, i mbajtur më 21 qershor 2025, u drejtohej artistëve, aktivistëve, OJQ-ve dhe përfaqësuesve institucionalë vendas dhe ndërkombëtarë që ishin pjesë e festivalit.

UNMASC! është një projekt ndërkombëtar dyvjeçar për kërkimin artistik dhe teatrin i zhvilluar në të gjithë Kosovën, Serbinë dhe Austrinë. Në bashkëpunim me organizatat partnere - Kulturhaus Brotfabrik (Austri) dhe Kulturanova (Serbi) - projekti promovon drejtësinë gjinore duke sfiduar narrativat patriarkale dhe duke amplifikuar zërat e marginalizuar përmes artit të angazhuar shoqërisht.

Fletushka nxori në pah komponentët kryesorë të projektit: kërkimin artistik transnacional, avokimin për drejtësinë gjinore përmes teatrit dhe përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve. Gjithashtu prezantoi dy produksionet kryesore teatrale deri më tani: Dream

On, me regji nga Danilo Jovanović (Vjenë: 24–26 prill 2025; Prishtina: 28 prill 2025), dhe There are no trends today, me regji nga Uroš Mladenović (Novi Sad: 30 prill, 30 maj dhe 22 qershor 2025; Vjenë: 7 qershor 2025).

Për më tepër, Ismaili njoftoi premierën e ardhshme të një produksioni të tretë teatrale në kuadër të projektit UNMASC!, me regji nga Zana Hoxha, i planifikuar të debutojë në korrik në Prishtinë dhe Novi Sad. Kjo shfaqje do të kulmojë udhëtimin krijues të projektit UNMASC!, i cili vazhdon të shërbejë si një platformë e fuqishme për solidaritet ndërkufitar, shprehje artistike dhe transformim shoqëror.

Projekti u promovua gjatë gjithë festivalit nëpërmjet fletëpalosjeve të shpërndara midis më shumë se 150 personave, përfshirë artistë, aktivistë, mysafirë vendas dhe ndërkombëtarë, dhe palë të interesuara institucionale. Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimin e një audience të larmishme në misionin dhe vlerat e projektit.

KONFERENCA VIRTUALE “JEHONAT E PAQES: RIIMAGJINIMI I HISTORISË PËRMES TEATRIT”



Me 24 Nëntor 2025, Konferenca Virtuale “Jehonat e Paqes: Riimagjinimi i Historisë Përmes Teatrit”, në kuadër të projekti HOPE – Historia e Paqes për Edukimin përmes Teatrit, na kujtoi një të vërtetë thelbësore: paqja nuk është diçka abstrakte – është një aftësi që mund ta mësojmë, ti mësojmë të tjerët dhe ta ndërtojmë së bashku.

Folësit theksuan se historia e rajonit tonë nuk përcaktohet vetëm nga luftërat. Periudha e Vinçës, Kosova në vitet 1970, Doclea dhe epoka të tjera paqësore tregojnë se bashkëpunimi dhe kreativiteti kanë rrënjë të thella këtu. Kur të rinjtë i mësojnë këto histori, ata mund të imagjinojnë një të ardhme të ndryshme – një të ardhme ku paqja është e mundur.

Mesazhet kryesore nga konferenca:

Paqja duhet të jetë aktive – e ndërtuar mbi drejtësi, dinjitet dhe barazi.


Artidheteatritransformojnë—dukeindihmuartërinjtëtë praktikojnë empatinë dhe të ripërcaktojnë narrativat. Të rinjtë duan edukim të vërtetë për paqen – dialog, mendim kritik dhe metoda krijuese.

Studiues, organizata partnere dhe pjesëmarrës të rinj frymëzues nga trajnime ndërkombëtare dhe lokale të gjithë ndanë mendime të vlefshme, duke vërtetuar se paqja ndërtohet nga njerëz – edukatorë, artistë, gra dhe të rinj që refuzojnë të trashëgojnë frikën dhe përçarjen.

Manuali i ri HOPE përmes platformës MOOC ofron mjete praktike për edukim kuptimplotë dhe krijues për paqen në të gjithë rajonin.

Nëse i studiojmë periudhat paqësore aq seriozisht sa studiojmë luftën – dhe nëse i angazhojmë të rinjtë përmes metodave pjesëmarrëse – paqja bëhet e arritshme.

Konferenca shënoi një moment të rëndësishëm në projektin Erasmus+ të zbatuar nga: DAH Teatar (Serbi), Action Synergy (Greqi), Teatro Aeroploio (Greqi), Artpolis (Kosovë), World Vision BH (BiH) dhe PRONA (Mali i Zi).



KLUBET TEATRORE DHE TRAJNIMI “EDUKIMI I BAZUAR NË TEATËR”

Teatri mbetet një nga mjetet kyçe të Artpolis për nxitjen e krijimtarisë artistike, aktivizmit feminist dhe fuqizimit të të rinjve dhe të rejave. Gjatë vitit 2025, Artpolis ka themeluar katër Klube Teatrore në Ferizaj, Pejë, Suharekë dhe Gjilan, duke përfshirë gjithsej 58 të rinj dhe të reja nga komunitete të ndryshme.

Nën mentorimin e aktorëve profesionistë, pjesëmarrësit/et klubeve teatrore u bënë pjesë të trajnimit “Edukimi i Bazuar në Teatër” ku më pastaj zhvilluan dhe prezantuan katër shfaqje të forum teatrit, të ndjekura nga rreth 475 persona në audiencë. Këto shfaqje u ndërtuan mbi temat dhe sfidat reale të komuniteteve ku u zhvilluan trajnimet, duke trajtuar çështje sociale të ndjeshme si pabarazia gjinore, dhuna, diskriminimi, presioni social dhe mungesa e hapësirave të sigurta për të rinjtë.

Përmes këtij procesi, teatri u përdor jo vetëm si formë artistike, por edhe si mjet edukimi, reflektimi dhe dialogu, duke kontribuar në rritjen e vetëdijes shoqërore dhe fuqizimin e pjesëmarrësve për të adresuar sfidat me të cilat përballen në jetën e përditshme.

KLUBI TEATRORE NË FERIZAJ



Më 18 shkurt 2025, Artpolis, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të Artit “Çesk Zadeja”, themeloi Klubin Teatror në Ferizaj. Ky aktivitet kishte për qëllim krijimin e një hapësire të sigurt dhe frymëzuese për të rinjtë, ku ata patën mundësinë të shprehin kreativitetin e tyre, të zhvillojnë aftësitë skenike dhe të eksplorojnë temat që i preknin më së shumti përmes teatrit.

Pjesëmarrësit u angazhuan në procesin krijues përmes trajnimit “Edukimi i Bazuar në Teatër”, duke u njohur me fuqinë e artit si mjet reflektimi dhe ndryshimi shoqëror. Nën mentorimin e aktorëve Kushtrim Qerimi dhe Dora Xhemajli, të rinjtë punuan mbi dramën klasike “Romeo dhe Zhulieta” të William Shekspirit, duke e trajtuar atë nga perspektiva bashkëkohore dhe duke hulumtuar temat e dashurisë, përçarjes dhe rebelimit të të rinjve në shoqëri.

Si pjesë e këtij procesi, u krijua një shfaqje forum teatër, e cila synoi të nxisë ndërveprimin me audiencën dhe reflektimin mbi tema sociale të rëndësishme. Përmes kësaj metode, publiku u ftua të bëhej pjesë aktive e dialogut dhe të eksploroonte mundësi të ndryshme për ndryshim shoqëror.

Përveç zhvillimit të aftësive skenike, pjesëmarrësit përmirësuan edhe shkathtësi jetësore si komunikimi, bashkëpunimi, mendimi kritik dhe zgjidhja kreative e problemeve, duke u fuqizuar për të vepruar si qytetarë aktivë dhe të ndërgjegjshëm.

SHFAQJA FORUM TEATËR “ZHULIETA E ZHULIETA” SFIDON NORMAT SHOQËRORE PËRMES DASHURISË



Më 18 prill 2025, Klubi Teator në Ferizaj prezantoi në Teatrin e Qytetit “Adriana” shfaqjen forum teatër “Zhulieta e Zhulieta”, një ri-interpretim i guximshëm i tragjedisë klasike “Romeo dhe Zhulieta” të Shakespeare-it.

Kjo shfaqje nuk ishte thjesht një përshtatje e njohur, por një eksplorim mbi dashurinë, identitetin dhe rebelimin, i realizuar nga të rinjtë e Ferizajt. E vendosur në një kafe-teatër, ajo krijoi një hapësirë dinamike ku personazhet sfiduan normat shoqërore dhe konceptet tradicionale të dashurisë. Përplasja mes dy regjisorëve me qëndrime të kundërta nxiti debat të gjallë me rreth 90 persona në audiencë, duke e kthyer shfaqjen në një platformë dialogu dhe reflektimi.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e mesazhit të barazisë dhe të drejtës për të dashuruar lirshëm, pavarësisht gjinisë.

Sipas tyre, përmes kësaj shfaqjeje synuan të fuqizojnë vajzat dhe djemtë e rinj për të përhapur një mesazh pozitiv kundër paragjyqimeve dhe diskriminimit.

Aktoret dhe aktorët—Arliza Ilazi, Daorsa Neretva Sopa, Djellza Musliu, Enea Reka, Erza Musliu, Mario-la Rexhepi, Orgesa Jakupaj, Orgesa Kçiku dhe Riad Xhafaj—u mentoruan nga aktorët Kushtrim Qerimi dhe Dori Xhemajli.

Interpretimi i tyre emocional dhe i angazhuar vuri në pah sfidat ndaj stereotipeve që kufizojnë individët. Pjesë e aktivitetit ishte edhe një ekspozitë me punime nga të rinjtë e klubit.

“Zhulieta e Zhulieta” dëshmoi fuqinë e teatrit si mjet për ndryshim shoqëror dhe fuqizim personal. Ndikimi i saj shkoi përtej skenës, duke ftuar publikun të reflektojë mbi identitetin, barazinë dhe konstruktet shoqërore që formësojnë jetët tona.

KLUBI TEATRORE NË PEJË



Më 19 shkurt 2025, Artpolis themeloi Klubin Teatror në Pejë, në bashkëpunim me Komunën e Pejës dhe Gjymnazin “Bedri Pejani”. Kjo iniciativë synon të krijojë një hapësirë të sigurt dhe krijuese për të rinjtë, ku ata mund të zhvillojnë shkathtësitë artistike dhe të fuqizohen përmes teatrit.

Pjesëmarrësit e ndjekën trajnimin “Edukimi i Bazuar në Teatër”, një metodologji që ndërthur artin dhe edukimin për të nxitur reflektim dhe dialog shoqëror. Nën mentorimin e aktorëve Fitore Broqi dhe Ismail Kasumi, të rinjtë punuan mbi dramën “Ëndrra e një Nate Vere” të Shekspirit, duke e risjellë atë përmes interpretimit të tyre kreativ.

Si rezultat, klubi prezantoi një shfaqje forum teatër, e cila do të trajtojë tema sociale relevante për komunitetin dhe do të përfshijë audiencën në diskutim. Përmes këtij procesi, të rinjtë do të zhvillojnë aftësi artistike dhe jetësore, si komunikimi, mendimi kritik, bashkëpunimi dhe vetëbesimi, duke e kthyer teatrin në një mjet të fuqishëm për ndryshim shoqëror.

VAJZAT SFIDOJNË NORMAT PËRMES SHFAQJES FORUM TEATËR “ANDRRA E NJË NATE VERE”



Shfaqja “Andra e Një Nate Vere”, e bazuar në dramën klasike të William Shakespeare, u jetësua nga vajzat e Klubit Teator në Pejë, më 24 prill, 2025 në Kino “Jusuf Gërvalla”.

E realizuar në një version modern, një ndërthurje e komedisë, dramës e parodisë “Andra e Një Nate Vere” sfidoi guximshëm normat shoqërore të mbivendosura nga sistemi patriarkal që e kanë formësuar jetën tonë, me theks të veçantë – dominimin e burrave.

Kjo shfaqje ndërthurte me humor dhe ironi të mprehtë dhunën, padrejtësitë dhe kontrollin që ju ushtrohet grave, duke ofruar një kritikë të thellë të një shoqërie që ende kërkon të ruajë pozitat patriarkale. Gratë në këtë shfaqje nuk ishin vetëm figura pasive, por aktive që sfidonin realitetin e tyre të thyer dhe kërkonin të rimerrnin lirinë e munguar. Shfaqja bënte

thirrje për një reflektim të thellë rreth ndihmës që mund të ofronte dashuria dhe solidariteti mes grave në përballjen me këto sfida, duke hapur një debat të guximshëm rreth maskulinitetit toksik, shfrytëzimit të grave dhe keqpërdorimit të teknologjisë, sidomos rrjeteve sociale si TikTok, për të ushtruar ndikim dhe kontroll mbi to.

Pas shfaqjes, një diskutim i pasur me publikun theksoi se çfarë ndodhte kur gratë merrnin skenën dhe si kjo mund të shndërrohej në një akt revolte. Për më shumë se 180 persona që ishin të pranishëm, shfaqja ofroi mundësinë për një dialog të hapur dhe kritik rreth dinamizmit shoqëror dhe rolit të grave në të. Publiku ishte i ftuar të mendonte se si shoqëria mund të ndryshonte përmes artit, një narrative që mund të dëshmonte fuqinë e gruas dhe nevojën për të kërkuar barazi dhe drejtësi.

“Andrra e Një Nate Vere” ishte një thirrje për vetëdijesim, përmes përdorimit të humorit dhe parodisë si armë për të sfiduar realitetin. Ajo shprehu fuqinë e gruas, por edhe dëshirën për të krijuar një shoqëri të drejtë ku kontrolli dhe dhuna nuk do të ishin më pjesë e jetës së tyre.

Shfaqja u jetësua nga Dea Mehmetaj, Elma Smaka, Erijona Dervishaj, Erjona Kurtaj, Erza Bërdynaj, Fiona Mehmetaj, Klea Emiri, Orgesa Haxhijaj, Rineta Morina, Vesa Kastrati, të cilat janë mentoruar nga Fitore Broqi dhe Ismail Kasumi.

Dea Mehmetaj, ka thënë se kjo përvojë me Klubin Teatoror i ka ndihmuar me e larguar stresin e me dalë në skenë.

“Unë kam pasur emocione që nga fillimi, por kjo më ka ndihmuar t’i heq emocionet. Tash mund të dalë në

skenë, dhe nëse bëj ndonjë gabim, si aktor duhet të dalësh nga situata. Jo vetëm në teatër, por edhe në jetën reale – nëse je duke bërë një gabim, nuk duhet të ndalesh, por të vazhdosh dhe ta përmirësosh”, ka thënë Mehmetaj, pjesëmarrëse në Klubin Teatoror në Pejë.

Erijona Dervishaj pati një mesazh të fuqishëm për rolin transformues të teatrit dhe artit, që tejkalon individin dhe flet për përgjegjësinë kolektive.

“Kjo që kemi bërë nuk është vetëm për veten tonë, por edhe për të tjerët. Është ndryshe kur e themi diçka, dhe ndryshe kur e veprojmë dhe e përjetojmë. Kjo është diçka shumë e fuqishme dhe duhet t’iu dedikohet të gjithëve”, ka thënë ajo.



TEATRI SI SHKOLLË JETE: “YOUTH NETWORKING EVENT” BASHKON TË RINJTË E KLUBEVE TEATRORE



Në një atmosferë të ngrohtë, plot energji dhe kreativitet, më 26 dhe 27 prill 2025, Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet organizoi punëtorinë dyditore “Youth Networking Event”, e cila bashkoi 19 të rinj dhe të reja nga klubet teatrore të shumë qyteteve të Kosovës. Ky takim u shndërrua në një hapësirë të veçantë reflektimi, mësimi dhe lidhje, duke nxjerrë në pah fuqinë e teatrit jo vetëm si art, por si një mjet për zhvillim personal, social dhe qytetar.

Të rinjtë morën pjesë në një seri ushtrimesh praktike dhe diskutimesh të udhëhequra nga mentorët Zana Hoxha, Blerta Gubetini, Edlir Gashi, Fitore Broqi, Ismaili Kasumi, Labinot Raci, Qendresa Kajtazi, dhe Elira Lluka. Përmes lojërave teatrale, punës në grup, improvizimeve dhe teknikave të ndërgjegjësimit emocional e trupor, pjesëmarrësit forcuan aftësitë e tyre artistike në ndërtimin e karaktereve dhe skenave, por edhe zhvilluan një sërë shkathtësish të jetës, të cilat shtrihen përtej skenës.

Të rinjtë ndanë me emocion reflektimet e tyre mbi përvojën në klubet teatrore. Për shumë prej tyre, skena ishte vendi ku mposhtën frikën, ku gjetën zërin e tyre, dhe mësuari si të shprehin ndjenjat pa pasur frikë. Aftësia për të bashkëpunuar, për të dëgjuar të tjerët, për të qenë të durueshëm dhe për të menaxhuar kohën dhe emocionet janë vetëm disa nga mësimet që përmenden shpesh nga pjesëmarrësit.

“Klubi teatror na ka ndihmuar të jemi më të hapur, të mos ngurrojmë të shprehim mendimet tona, të njohim njerëz të rinj dhe të përshtatemi me mentalitete të ndryshme,” u shpreh një nga pjesëmarrëset. Për shumë të tjerë, teatri ka ndikuar drejtpërdrejt për të mësuari mbi rëndësinë e disiplinës, përpjekjes së vazhdueshme, menaxhimit të kohës e bashkëpunimit.

Përtej skenës, klubet teatrore kanë qenë për të rinjtë një hapësirë ku adresohen çështje sociale, përfshirë barazinë gjinore, dhunën, diskriminimin dhe të drejtat e njeriut. Këto tematika janë trajtuar jo vetëm në shfaqjet që ata kanë realizuar, por edhe në procesin e krijimit, ku janë ndërtuar bashkëbisedime të hapura dhe të thella.

“Ky trajnim na ka frymëzuar që të vazhdojmë të angazhohemi në komunitet, të krijojmë projekte që përfshijnë të rinj nga të gjitha etnitë dhe grupmoshat,” shprehet një pjesëmarrës tjetër.

Shumë prej të rinjve që morën pjesë shprehin dëshirën për të vijuar në rrugën e artit, duke e parë teatrin si thirrje dhe profesion të ardhshëm. Të tjerë synojnë të jenë aktorë të ndryshimit në komunitetet e tyre – si trajnerë, aktivistë apo edukatorë, duke i përdorur teknikat teatrale si mjete për vetëdijesim dhe fuqizim shoqëror.

Nga loja me karrige te ndërtimi i “kornizave të ngrira” që përfaqësojnë temat shoqërore, nga ushtrimet e reflektimit emocional deri tek performancat kolektive, “Youth Networking Event” dëshmoi se teatri është shumë më tepër se një art – është një formë edukimi, një udhë për zhvillim personal dhe një instrument për transformim shoqëror.

Në një kohë kur të rinjtë përballen me pasiguri dhe sfida të mëdha, kjo përvojë e përbashkët në teatër i forcon, i lidh dhe u jep zë.

Siç e përshkruajnë vetë ata: “Në teatër mësuam se gabimi nuk është fundi i botës, përkundrazi – është pjesë e procesit kreativ. Dhe se duhet të jemi gjithmonë vetvetja, pavarësisht çfarë thonë të tjerët”.



THEMELOHET KLUBI TEATRORE NË SUHAREKË



Një udhëtim i ri artistik ka nisur në Suharekë! Më 16 tetor 2025, Shtëpia e Kulturës “Ukë Bytyqi” hapi dyert për një numër të madh të rinjsh entuziastë, të gatshëm të bëhen pjesë e Klubit Teatror. Interesimi i jashtëzakonshëm i këtyre të rinjve reflekton pasionin e tyre për krijimtarinë, shprehjen e vetvetes dhe ndryshimin shoqëror përmes artit.

Nën mentorimin e aktorëve Ismail Kasumi dhe Edona Sopaj, pjesëmarrësit do të nisin një udhëtim frymëzues të të mësuarit dhe zbulimit përmes trajnimit “Edukimi i Bazuar në Teatër”. Ata do të zhvillojnë aftësitë jetësore, vetëbesimin, punën në grup, empatinë dhe të menduarit kritik — ndërsa eksplorojnë botën e aktrimit, performancës dhe forum teatrit.

Klubi Teatror në Suharekë është më shumë se një hapësirë për art — është një hapësirë për rritje, dialog dhe transformim. Ai fuqizon zërat e të rinjve për të ndarë historitë e tyre, sfiduar stereotipet dhe imagjinuar një shoqëri më të mirë përmes kreativitetit dhe bashkëpunimit.

Ky aktivitet organizohet nga Artpolis, në bashkëpunim me Komunën e Suharekës, dhe mbështetet nga FRIEDA dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit — duke rritur gjeneratën e ardhshme të artistëve dhe ndryshuesve të shoqërisë në Kosovë.

“PLANI SEKRET” ME MESAZHE MBI NDIKIMIN POLITIK NË SISTEMIN ARSIMOR



Shfaqja forum-teatër “Plani Sekret”, e prezantuar nga Klubi Teator në Suharekë, ishte një eksperiencë e paharruar për të rinjtë dhe të rejtat që morën pjesë. Para një audience prej rreth 140 personash, nxënësit u angazhuan jo vetëm në interpretim, por edhe në diskutim të drejtpërdrejtë me personazhet, duke reflektuar mbi temat që prekën pushtetin, influencën dhe kontrollin brenda hapësirës së edukimit.

Në një shkollë ku rregullat duhej të ishin të qarta, shfaqja shpalsi një plan sekret, një mekanizëm të padukshëm që ndërthurte mashtrimet, ambiciet dhe lojërat politike me jetën e përditshme të nxënësve. Publiku u bë pjesë e lojës, sfiduan personazhet dhe hapën një dialog të gjallë mbi atë që ndodh kur edukimi nuk i shërben më dijes, por interesave të fshehta.

Të rinjtë e Gjimnazit “Jeta e Re” dhe Institucionit të Arsimit dhe Aftësisit Profesional “Abdyl Ramaj” – Albi, Andi, Ariola, Altina, Diar, Diona, Ela, Erdonesa, Erina, Eros, Ledjona, Leonida, Muhamet, Nora, Orge-sa, Rigon, Tringa dhe Vanesa – nën mentorimin e aktorëve Ismail Kasumi dhe Edona Sopaj, shfaqën guxim, energji dhe një përkushtim të jashtëzakonshëm, duke kthyer skenën në një hapësirë ku secili ndjeu se kishte një rol aktiv në historinë që zhvillohej.

Të rinjtë e Klubit Teator në Suharekë e konsideruan këtë përvojë si një udhëtim të paharrueshëm, që jo vetëm i sfidoi artistikisht, por i përgatiti për të kuptuar fuqinë e teatrit si mjet për diskutim dhe ndryshim.

THEMELOHET KLUBI TEATORR NË GJILAN



Më 17 tetor 2025, në Gjilan u bë një hap i rëndësishëm për artin dhe të rinjtë e qytetit me themelimin e Klubit Teatorr. Ky klub ofron një mundësi unike për të rinjtë që të eksplorojnë talentin e tyre artistik dhe të zhvillojnë aftësi të reja përmes teatrit.

Mentorë të këtij klubi janë aktorët Kushtrim Qerimi dhe Fitore Jashari, të cilët do të udhëheqin të rinjtë në rrugëtimin e tyre artistik. Pjesëmarrësit do të mësojnë jo vetëm bazat e aktrimit dhe performancës, por edhe aftësi të rëndësishme jetësore si

bashkëpunimi, kreativiteti, vetëbesimi dhe shprehja e ideve përmes artit.

Klubi Teatorr në Gjilan synon të krijojë një komunitet aktiv artistik, ku të rinjtë mund të shprehin historitë e tyre, të sfidojnë stereotipet dhe të kontribuojnë në ndryshimin shoqëror përmes krijimtarisë teatrale.

“A PO M’NIN” – NJË PASQYRË E GUXIMSHME E DILEMAVE TË RINISË



Premiera e shfaqjes forum-teatër “A po m’nin”, e cila u zhvillua më 10 dhjetor në Teatrin e Qytetit në Gjilan, ishte një thirrje për reflektim. Para një audience të përkushtuar prej 65 personash, personazhet u shndërruan në pasqyrë të dilemave të rinisë dhe pasigurisë që lind kur kujdesi shoqëror humbet në rrëmujën e ndryshimeve.

Në qendër të historisë qëndron Jara, një vajzë e re përballë zgjedhjeve që mund t’i ndryshojnë rrjedhën e jetës. Përmes heshtjes, shpërfilljes dhe braktisjes, shfaqja na tregon se si pasiguria mund të gllabërojë vetëbesimin dhe si rrjedhim pasojat mund të jenë të thella dhe të gjerë.

Performanca e nxënësve nga Gjimnazi “Xhavit Ahmeti” dhe Shkolla e Mesme e Artit “Adem Kastrati” – Muharrem Ramadani, Eris Selimi, Isra Sahiti, Anisa Koprani, Donesa Musliu, Ajsin Sahiti, Lina Bislimi, Atika Salihi, Kanita Mehmeti, Delfina Halimi, Altesa Byqmeti,

Blinera Miftari dhe Rrezarta Rrahmani – ishte një udhëtim emocional që lidhi publikun në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrëfimin. Diskutimi aktiv midis aktorëve dhe publikut solli një dimension tjetër, duke kthyer shfaqjen në një dialog të hapur për përgjegjësinë sociale dhe përkujdesjen ndaj rinisë.

Mentorimi i aktorëve Kushtrim Qerimi dhe Fitore Jashari e bëri këtë përvojë edhe më të veçantë, duke krijuar një hapësirë të sigurt dhe të frytshme për të rinjtë e talentuar të Klubit Teatror të Gjilanit.

Siç e përshkruan Muharrem Ramadani, pjesë e klubit, ishte “një aventurë jetësore” dhe “kenaqësi” që krijoi lidhje të forta.

Shfaqja “A po m’nin” është dëshmi e fuqisë së teatrit për të zgjuar ndërgjegjen, për të hapur diskutime dhe për të lidhur shoqërinë me emocionet e të rinjve.

FUQIZIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Gjithëpërfshirja dhe diversiteti janë dy nga karakteristikat që e bëjnë të veçantë punën e Artpolis, prandaj Artpolis ka vazhduar këtë angazhim edhe në 2025, në përkrahje të personave me aftësi të kufizuara.

DOKUMENTARI “BIBA MAY – JO MË”



Dokumentari “Biba May – Jo Më”, në kuadër të aktivitetit Shkolla Pranverore Feministe, u shfaq për pjesëmarrëset e shkollës më 11 maj 2025 në Kino Lumbardhi, Prizren. Ky dokumentar kontribuoi në ndriçimin e historisë frymëzuese të Biba May, duke i dhënë hapësirë protagonistës Resmije Rahmani që të ndajë rrëfimin e saj jetësor me gratë pjesëmarrëse.

Pas shfaqjes, Rahmani zhvilloi një bisedë të hapur me gratë e reja mbi sfidat me të cilat është përballur

dhe mënyrat se si i ka tejkaluar ato, duke i inkurajuar të ndjekin ëndrrat e tyre dhe të fokusohen në zhvillimin dhe arritjet personale. Komunikimi i saj i drejt-përdrejtë dhe i sinqertë pati një ndikim të fuqishëm, duke i frymëzuar pjesëmarrëset të reflektojnë mbi forcën e tyre të brendshme dhe potencialin për të ndërtuar një të ardhme më të mirë.

RRITJA DHE NGRITJA E KAPACITETEVE TË ARTPOLIS

Krahas zbatimit të aktiviteteve dhe angazhimit për fuqizimin e grupeve të marginalizuara, Artpolis punon vazhdimisht në ngritjen e kapaciteteve të veta organizative dhe profesionale. Kjo realizohet përmes organizimit të punëtorive dhe trajnimeve, si individuale ashtu edhe grupore, për stafin e angazhuar në organizatë, si dhe përmes pjesëmarrjes së stafit në trajnime dhe punëtori të jashtme, me qëllim zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe forcimin e qëndrueshmërisë së organizatës.

PUNËTORIA “ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT DHE VLERËSIMI I PUNËS”



Artpolis organizoi një punëtori dyditore në ambientet malore të Brezovicës më 3 dhe 4 prill 2025, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të brendshme të stafit, rritjes së efikasitetit organizativ dhe vlerësimit të punës së deritanishme.

Gjatë këtyre dy ditëve, fokusi kryesor ishte edicioni i 13-të i Festivalit FemArt, i cili do të mbahet më 16-21 qershor, 2025. Stafi diskutoi me përkushtim mbi përmbajtjen dhe strukturën programore të festivalit, duke bërë planifikim të detajuar të aktiviteteve artistike, edukative dhe avokuese që do të zhvillohen. U analizuan përvojat nga edicionet e mëparshme, u vlerësuan sfidat dhe arritjet, dhe u ndërtuan hapa konkretë për përmirësimin e mëtejshëm të procesit organizativ dhe të komunikimit me publikun dhe bashkëpunëtorët.

Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e punëtorisë iu kushtua planifikimit të aktiviteteve të tjera të Artpolis për vitin 2025. U diskutuan gjithashtu edhe projektet e ardhshme, me fokus në ndërkombëtarizimin e aktiviteteve, përfshirjen e të rinjve dhe fuqizimin e grupeve të marginalizuara nëpërmjet artit.

Një komponent tjetër thelbësor i punëtorisë ishte diskutimi rreth strategjive të reja për ngritjen e fondeve. U shqyrtuan mundësi bashkëpunimi me donatorë lokalë dhe ndërkombëtarë, si dhe mënyrat për të rritur vizibilitetin dhe ndikimin e organizatës përmes partneriteteve strategjike.

ARTPOLIS THEMELON STACIONIN KULTUROR



Pas më shumë se dy dekadave pune dhe përkushtimi, Artpolis po themelon STACIONIN KULTUROR në zemër të Prishtinës – një hapësirë fizike që do të ofrojë kushte për krijime artistike, reflektim dhe bashkëkrijim me komunitetin.

Hapësira është dizajnuar nga Maden Group dhe përmban një skenë, galeri, zyra dhe një bar. Një objekt i braktisur dhe i harruar, përmes dizajnit dhe revitalizimit të qëndrueshëm, po kthehet në funksion dhe po shndërrohet në një pikëtakim të artistëve dhe komunitetit – një shtëpi e re për artin dhe shoqërinë.

Me 30.09.2025, patëm kënaqësinë që, së bashku me Drejtoreshën e Artpolis, Zana Hoxha, menaxheren e programeve Venera Ismaili, si dhe arkitektët Ideal Vejsa, arkitekt dhe drejtor ekzekutiv i Maden Group, dhe Riona Cuci, dizajnere enterieri, ta mirëpresim Kryetarin e Prishtinës z. Përparim Rama dhe Drejtorinë e Kulturës të udhëhequr nga znj. Sibel Halimi, të cilët kanë përkrahur iniciimin e kësaj qendre për Arbërinë dhe për gjithë qytetin.

ANDI HAZIRI ZGJIDHET KRYETAR I ANËTARËSISË SË ARTPOLIS



Më 20 tetor 2025, gjatë Mbledhjes së Tretë të Kuvendit të Anëtarëve të mbajtur në Hotel Sirius në Prishtinë, Andi Haziri u zgjodh Kryetar i Anëtarësisë së Artpolis. Zgjedhja u zhvillua përmes një procesi transparent dhe votimi anonim mes dy kandidatëve, Andi Haziri dhe Erblina Luma, ku Andi mori shumicën e votave.

Takimi, i moderuar nga Zana Hoxha, Themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive e Artpolis, mbledhi rreth 30 pjesëmarrës, përfshirë anëtarët dhe stafin e organizatës. Zana hapi sesionin duke reflektuar mbi vlerat e përbashkëta dhe misionin afatgjatë të organizatës, si dhe prezantoi hapësirën e re “Stacioni Kulturor i Prishtinës” – një qendër multifunksionale e artit dhe aktivizmit me skenë prej 600 m², galeri, bar dhe oborr skulpturash, e konceptuar si një hapësirë e hapur dhe gjithëpërfshirëse për komunitetin.

Menaxherja e projekteve, Venera Ismaili, prezantoi një përmbledhje të aktiviteteve kryesore të realizuara gjatë vitit 2025, si dhe ngjarjet që pritet të mbahen në muajt e fundit të vitit, duke theksuar ndikimin e vazhdueshëm të Artpolis në art, edukim dhe barazi gjinore.

Takimi u përmbyll me urimet për Andi Hazirin në rolin e tij të ri dhe me zotimin për të forcuar më tej angazhimin e anëtarëve. Pjesëmarrësit e mbyllën takimin në një atmosferë miqësore, me dëshirën që mbledhja e radhës të mbahet në hapësirën e re të Artpolis – Stacioni Kulturor i Prishtinës.

PJESËMARRJE NË PUNËTORINË PËR LIDERSHIP NË AGJENDËN PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË



Me 29.01.2025, Artpolis pati kënaqësinë të ishte pjesë e punëtorisë së organizuar nga Qendra Rajonale e Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë.

Menaxherja e projekteve në Artpolis, Venera Ismaili, mori pjesë në këtë aktivitet, i cili kishte në fokus ritheksimin e rëndësisë së Planeve Kombëtare të Veprimit (PKV) për Gratë, Paqen dhe Sigurinë si instrumente kyçe për avancimin e barazisë gjinore, si dhe për ndërtimin e paqes dhe sigurisë gjithëpërfshirëse.

Qëllimi kryesor i punëtorisë ishte prezantimi i perspektivave ndërkombëtare mbi hartimin dhe zbatimin

e PKV-ve, përmes kontributit të ekspertit ndërkombëtar për PKV-të, Mirsad Jacevic. Gjatë diskutimeve u theksuan praktikatat e mira, sukseset dhe sfidat me të cilat janë përballur shtetet që kanë miratuar dhe zbatuar këto plane.

Punëtorja mblodhi përfaqësues të institucioneve qeveritare, shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme dialogu mes akterëve kyç të fushës.

VIZITAT DHE BASHKËPUNIMET

Artpolis ka vazhduar edhe këtë vit me ndarjen e përvojave me persona të jashtëm, organizata artistike, studente/ë vendorë e ndërkombëtarë, partnerë e donatorë duke i pritur në zyret e saj apo edhe në hapësira të tjera.

Disa nga vizitat që Artpolis mirëpriti përgjatë vitit 2025 dhe bashkëpunimet jashtë zyreve të Artpolis ishin:



Studente/ë nga EMA dhe VMAAHR (Italia dhe Austria) vizitojnë Artpolis-in- Më 25 janar 2025, Artpolis mirëpriti 25 studente nga programet EMA (European Master's in Human Rights and Democratisation, Venecia) dhe VMAAHR (Vienna Master of Arts in Applied Human Rights, Austri) në një vizitë njohëse mbi punën e organizatës në artin dhe aktivizmin feminist.

Menaxherja e projekteve, Venera Ismaili, dhe koordinatori i projekteve, Berat Bajrami, prezantuan misionin dhe qasjen e Artpolis në ndërtimin e paqes dhe fuqizimin shoqëror përmes artit. Ata ndanë përvoja konkrete se si teatri, punëtoritë dhe projektet artistike përdoren për të sfiduar stereotipet gjinore, për të adresuar çështje të ndjeshme sociale dhe për të nxitur ndryshim shoqëror.

Gjatë diskutimit u trajtuan edhe sfidat e punës së Artpolis, bashkëpunimet lokale dhe ndërkombëtare, si dhe roli i Festivalit FemArt si platformë unike që lidh artin me aktivizmin për barazi gjinore. Takimi krijoi një hapësirë frymëzuese shkëmbimi mes studentëve dhe Artpolis, duke riafirmuar artin si mjet të fuqishëm për drejtësi sociale dhe shoqëri më gjithëpërfshirëse.

Ambasada e Australiane në Zagreb viziton Artpolis: Më 04.06.2025, Artpolis pati kënaqësinë të mirëpresë znj. Anna Robens, Konsulle, dhe znj. Re-

nata Buljubasic, Zyrtare Konsullore, nga Ambasada Australiane në Zagreb, Kroaci. Gjatë vizitës u zhvillua një diskutim domethënës mbi çështjet e të drejtave të grave, dhunën në familje dhe kontekstin më të gjerë të dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Takimi shërbeu si një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe hapjes së mundësive për bashkëpunim konkret në të ardhmen, në fushën e artit, aktivizmit dhe fuqizimit të grave.



Artpolis u mirëpriti në Itali: Me 5 shtator 2025, në zyret e AMA – Accademia Mediterranea dell'Attore, në Lecce / Itali, u zhvillua një takim me menaxhmentin e Festivalit Tempora / Contemporanea, ku morën pjesë Zana Hoxha, themeluese dhe drejtore e ekzekutive e Artpolis dhe FemArt, njëherësh bashkë-regjisore e shfaqjes "Gratë e Trojës", Maja Mitić, bashkë-regjisore dhe aktore e shfaqjes, si dhe Franco Ungaro, drejtor artistik i festivalit dhe i AMA – Accademia Mediterranea dell'Attore. Takimi shërbeu për shkëmbim idesh dhe diskutime mbi bashkëpunimet artistike, prezantimin e shfaqjeve në kontekste ndërkombëtare dhe forcimin e lidhjeve kulturore ndërmjet institucioneve dhe festivaleve.



Përfaqësueset e Artpolis u mirëpritën nga Ambasadori i Kosovës në Paris: Në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Paris, përfaqësueset e Artpolis – Zana Hoxha, Drejtore Ekzekutive e Artpolis/FemArt, dhe Venera Ismaili, Menaxhere e Projekteve – u mirëpritën nga Shkëlqesia e Tij, z. Mehdi Halimi, Ambasador i Republikës së Kosovës në Francë, si dhe nga z. Shemsi Krasniqi, sociolog dhe Përfaqësues i Kosovës në Frankofoni, më 18 shtator, 2025.


Ambasadori Halimi përshëndeti pjesëmarrjen e Artpolis në festivalin prestigjioz WeToo Festival në Paris, duke vlerësuar kontributin e shfaqjes teatrale “Revolt. She Said. Revolt Again”, me regji nga Zana Hoxha, në pasurimin e dialogut kulturor ndërkombëtar.

Takimi u zhvillua në një atmosferë miqësore e bashkëpunuese, ku u trajtuan mundësitë për projekte të reja, forcimin e lidhjeve kulturore dhe promovimin e skenës artistike bashkëkohore të Kosovës në arenën ndërkombëtare, me theks të veçantë në Francë. Teatri u theksua si një urë e fuqishme e bashkëdyzimit të kulturave dhe si mjet i domosdoshëm për nxitjen e dialogut ndërkulturor.

Artpolis shpreh mirënjohje të veçantë për Ambasadën e Republikës së Kosovës në Paris, për mbështetjen dhe mikpritjen e ofruar gjatë këtij angazhimi kulturor.

Forum Space në kuadër të Forumit Ndërkombëtar:

Artpolis ishte prezente në edicionin e tretë të Forumit Ndërkombëtar WPS (Women, Peace and Security Forum), i organizuar nga Presidenca e Republikës së Kosovës, më 2–3 qershor 2025, në Hotel Emerald. Në kuadër të hapësirës Forum Space, e dedikuar për organizatat e shoqërisë civile, Artpolis prezantoi aktivitetet e saj përmes një këndi informues, ku u ekspozuan materiale promovuese të organizatës dhe të Festivalit Ndërkombëtar FemArt. Kjo hapësirë shërbeu gjithashtu si një mundësi e vlefshme për rrjetëzim dhe shkëmbim me vizitorë, pjesëmarrës dhe përfaqësues institucionalë, duke hapur mundësi për bashkëpunime të reja në fushën e artit, paqes dhe barazisë gjinore.



Takim pune: Integrimi i PSEA në Dokumentet Statutore të Partnerëve Implementues:

Më 22 dhjetor, UNFPA organizoi një takim pune me qëllim diskutimin e integritit të standardeve të Mbrojtjes nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (PSEA) në dokumentet statutorë të organizatave partnere implementuese. Takimi shërbeu gjithashtu si një sesion rinfreskues mbi parimet kryesore të PSEA dhe politikën e “Zero Tolerancë” të UNFPA-së.

Në këtë trajnim morën pjesë Venera Ismaili, menaxhere e projekteve, dhe Arbnora Bajraktari, asistente e financave, të cilat ndanë me pjesëmarrësit përvojat dhe dokumentet përkatëse të Artpolis lidhur me politikën dhe rregulloret e organizatës në fushën e PSEA.



Takimi Rrjetëzues dhe Planifikimi i Strategjisë së RRGK - Më 26–28 shtator 2025, menaxherja e projekteve e Artpolis, Venera Ismaili ishte pjesë Takimit Rrjetëzues dhe Planifikimit të Strategjisë së RRGK, në Durrës, i cili mbledhi përfaqësues dhe përfaqësues të organizatave anëtare për të reflektuar mbi drejtimet strategjike dhe prioritetet e ardhshme të rrjetit.



Ambasada e Francës viziton Artpolis: më 15.10.2025 patëm kënaqësinë të mirëpritjes së Ambasadorit të Nderuar të Francës, z. Olivier Guérot, dhe z. Edouard Mayoral, Këshilltar dhe Drejtor i Institutit Francez, në hapsirat e Artpolis.

Biseda jonë frymëzuese u përqendrua në forcimin e bashkëpunimit dhe miqësisë, veçanërisht përmes Festivalit FemArt dhe kapitullit të ri emocionues — Stacionit Kulturor që Artpolis do të menaxhojë së shpejti.

Jemi mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme dhe vizionin e përbashkët për promovimin e kulturës, artit dhe barazisë!



“Biseda e Fuqizimit” e fasilituar nga Boyd McKechnie, Këshilltar për Ndërtimin e Paqes:

Artpolis mori pjesë në një drekë rrjetëzimi dhe në diskutime në grup fokus, në kuadër të projektit “Biseda e Fuqizimit”, një iniciativë e përbashkët e Ambasadës Britanike dhe asaj Suedeze në Kosovë, e cila synon të forcojë besimin ndërmjet komuniteteve nga baza përmes dialogut gjithëpërfshirës. Takimi mbledhi pjesëmarrës nga sfera të ndryshme për të diskutuar çështje kyçe ndërsektoriale si të drejtat e grave, të rinjtë, mjedisi dhe biznesi, me fokus të veçantë në mundësitë për ndërtimin e besimit në Kosovë.

VLERËSIMI DHE MONITORIMI

Vlerësimi dhe monitorimi i aktiviteteve të Artpolis gjatë vitit 2025 janë realizuar përmes një sërë metodash të kombinuara, me qëllim sigurimin e një pasqyre sa më të saktë dhe gjithëpërfshirëse të ndikimit të tyre. Procesi ka përfshirë monitorimin e prezencës mediatike, përmes analizimit të mbulimit në media tradicionale dhe digjitale, si dhe të shtrirjes së aktiviteteve në platformat online.

Gjithashtu, janë përdorur pyetësorë për të mbledhur mendime, vlerësime dhe komente nga pjesëmarrësit dhe ndjekësit, duke mundësuar marrjen e feedback-ut të drejtpërdrejtë dhe të vlefshëm për cilësinë dhe përmbajtjen e aktiviteteve. Numri i pjesëmarrësve dhe audiencia e arritur janë monitoruar në mënyrë sistematike për të vlerësuar përmbushjen e objektivave dhe arritjen e grupeve të synuara.

Formularët e vlerësimit kanë shërbyer për të identifikuar pikat e forta, si dhe fushat që kërkojnë përmirësim. Për më tepër, intervistat me individë të përzgjedhur kanë ofruar analiza më të thelluara mbi ndikimin afatgjatë të aktiviteteve, duke kontribuar në përmirësimin e metodologjive dhe strategjive të planifikimit për aktivitetet e ardhshme. Ky proces vlerësimi ka ndihmuar gjithashtu në identifikimin e nevojave të reja dhe në orientimin e përpjekjeve të ardhshme drejt arritjes së objektivave strategjike të Artpolis.

SFIDAT DHE MËSIMET E NXJERRA

Organizimi dhe zbatimi i aktiviteteve të Artpolis dhe Festivalit FemArt gjatë vitit 2025 u shoqërua me një sërë sfidash, të cilat njëkohësisht shërbyen si burim i rëndësishëm mësimesh dhe reflektimi për punën e ardhshme.

Mungesa e hapësirave të përshtatshme dhe infrastruktura e kufizuar kulturore: Një nga sfidat kryesore ishte mungesa e hapësirave të përshtatshme kulturore dhe infrastruktura e kufizuar në Prishtinë, e shkakton si nga renovimet afatgjata të institucioneve kulturore publike, ashtu edhe nga politikat e brendshme të disa institucioneve (si Biblioteka Kombëtare, Muzeu Kombëtar, etj.), të cilat kufizojnë përdorimin e hapësirave të tyre vetëm në rastet e bashkëpunimit me institucionet shtetërore. Kjo situatë vështirësoi gjetjen e hapësirave adekuate të pajisura për shfaqje, ekspozita dhe punëtori.

Si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme advokuese, Artpolis arriti të lidhë një marrëveshje me Komunën e Prishtinës për revitalizimin e një objekti të pashfrytëzuar, me synimin që ai të shndërrohet në një qendër kulturore të menaxhuar nga Artpolis. Megjithatë, revitalizimi i objektit kërkon burime të konsiderueshme financiare. Në këtë drejtim, Artpolis ka nisur procesin e ngritjes së fondeve, ndërsa Komuna ka kontribuar fillimisht me largimin e materialit toksik (asbestit) nga kulmi i objektit. Pjesa tjetër e procesit mbetet përgjegjësi e Artpolis.

Vonesat në përgjigjet dhe transferet e fondeve: Një tjetër sfidë e rëndësishme ishin vonesat në marrjen e përgjigjeve ndaj aplikimeve për financim dhe në transferet e fondeve nga donatorët. Këto vonesa ndikuan drejtpërdrejt në planifikimin buxhetor dhe menaxhimin financiar të aktiviteteve dhe Festivalit FemArt. Mësimi i nxjerrë nga kjo përvojë është nevoja për parashikimin e vonesave të mundshme, planifikimin e afateve më realiste për mbledhjen e fondeve, ruajtjen e komunikimit të vazhdueshëm dhe transparent me donatorët, si dhe përpjekjet për thjeshtimin e procedurave financiare.

Kriza ekonomike dhe rritja e çmimeve: Aktivitetet e festivalit u zhvilluan në një kontekst të krizës ekonomike dhe inflacionit global, që rezultoi në rritje të çmimeve për shërbime dhe produkte. Kjo situatë solli sfida në menaxhimin e shpenzimeve, tërheqjen e sponsorëve dhe ofrimin e kushteve adekuate për pjesëmarrësit. Mësimi i nxjerrë ishte domosdoshmëria e fleksibilitetit financiar, kërkimi i partneriteteve me biznese lokale, optimizimi i kostove dhe aplikimi i qasjeve alternative për të siguruar qëndrueshmëri financiare.

Përplasjet në afate kohore me ngjarje të tjera: Një sfidë tjetër ishte mbivendosja e afateve kohore me ngjarje të tjera kulturore në Prishtinë, e cila ndikoi në ndarjen e audiencës dhe potencialisht në pjesëmarrjen e publikut në Festivalin FemArt. Nga kjo përvojë u nxor mësimi mbi rëndësinë e hulumtimit të hershëm të kalendarit kulturor lokal, koordinimit me organizatorët e tjerë dhe nxitjes së bashkëpunimit për të shmangur mbivendosjet e datave dhe për të rritur pjesëmarrjen e audiencës.

Mentaliteti patriarkal ndaj artit dhe aktivizmit kulturor vazhdojnë të jenë sfida të pranishme në punën në terren. Kjo u reflektua veçanërisht gjatë punës me Klubet Teatrore veçanërisht gjatë punës me Klubet Teatrore në Ferizaj, Pejë, Gjilan dhe Suharekë. Një nga sfidat kryesore ishte hezitimi i të rinjve për të dalë në skenë dhe për të performuar publikisht, i nxitur nga frika e bullizimit, si në hapësirat digjitale ashtu edhe në ato fizike. Ky presion shoqëror ndikoi drejtpërdrejt në vetëbesimin dhe gatishmërinë e tyre për shprehje artistike. Përmes punës së vazhdueshme pedagogjike dhe artistike, diskutimeve të hapura dhe krijimit të një mjedisi të sigurt dhe mbështetës, Artpolis kontribuoi në fuqizimin e të rinjve/rejave që të ndërmarrin vendime të pavarura për veten e tyre, të sfidojnë normat kufizuese dhe të marrin kontroll mbi shprehjen dhe rrugëtimin e tyre artistik. Kjo përvojë theksoi rëndësinë e artit si mjet për ndërtimin e vetëbesimit, rezistencës dhe autonomisë personale.

BLLOGJET

Për të pasqyruar aktivitetet e edicionet 13-të të Festivalit FemArt dhe të Artpolis, janë përkujdesur Shqipe Malushi, Gili Hoxhaj, Claudia Peschiutta dhe Shemsi Doda:

Nga Gili Hoxhaj

“Shkodra Elektronike” – si festë e përbashkët e çlirimit

<https://femart-ks.com/sq/shkodra-elektronike-si-feste-e-perbashket-e-clirimit/>

“Zëra të heshtur” u bënë zëra që dëgjohen, histori që lexohen

<https://femart-ks.com/sq/zera-te-heshtur-u-be-ne-zera-qe-degjohen-histori-qe-lexohen/>

“Tales of Scapes” si shpërthim muzikor e mozaik tingujsh

<https://femart-ks.com/sq/tales-of-scapes-si-shperthim-muzikor-e-mozaik-tingujsh/>

Një funeral për atë që s’na shërben më

<https://femart-ks.com/sq/nje-funeral-per-ate-qe-sna-sherben-me/>

Duart që çuan në këmbë krejt sallën

<https://femart-ks.com/sq/duart-qe-cuan-ne-kembë-krejt-sallen/>

Një performancë për ta përmbledhur veten në çdo etapë

<https://femart-ks.com/sq/nje-performance-per-ta-permblodhur-veten-ne-cdo-etape/>

Dhimbjet e padukshme të nënave behën më të zëshme se zëri i foshnjave

<https://femart-ks.com/sq/dhimbjet-e-padukshme-te-nave-behen-me-te-zeshme-se-zeri-i-foshnjave/>

Troja që na flet edhe sot

<https://femart-ks.com/sq/troja-qe-na-flet-edhe-sot/>

Nga Shqipe Malushi:

Marrja e Zezë – Varrosja e Turpit

<https://femart-ks.com/sq/marrja-e-zeze-varrosja-e-turpit/>

Duart e Zjarrit, Zemrat e Lirisë

<https://femart-ks.com/sq/duart-e-zjarrit-zemrat-e-lirise/>

Një rreth i shenjtë zërash u mblodh për Konferencën Ndërkombëtare: FemArt 13 “Çliro Mendjen Tënde”

<https://femart-ks.com/sq/nje-rreth-i-shenjte-zerash-u-mblodh-per-konferencen-nderkombetare-femart-13-cliro-mendjen-tende/>

Kori i Grave “OKARINA”

<https://femart-ks.com/sq/kori-i-grave-okarina/>

Shfaqje Teatrale: Gratë e Trojës – Kosovë & Serbi

<https://femart-ks.com/sq/shfaqje-teatrale-grate-e-trojes-kosove-serbi/>

Performancë Muzikore: Qualcosa di Grande – Itali

<https://femart-ks.com/sq/performance-muzikore-qualcosa-di-grande-itali/>

Vallja Botërore për Humanitetin

<https://femart-ks.com/sq/vallja-boterore-per-humanitetin/>

Nga Claudia Peschiutta

Gratë Flasin Hapur për Shëndetin Mendor Amësor

<https://femart-ks.com/sq/grate-flasin-hapur-per-shendetin-mendor-amesor/>

Nga Shemsi Doda

“Vojçeku”

<https://artpolis-ks.com/vojceku/>

STATISTIKAT E VITIT 2025

Aktivite:

+ **100**

Artiste/ë dhe aktiviste/ë:

+ **400**

Persona në audiencë:

+ **5500**

Artikujt të mediave

+ **100**

Milionë persona të arritur online:

+ **2.8**

SHFAQJET DHE PREZANTIMET PROFESIONALE

Shfaqje dhe prezantime profesionale:

6

Repriza:

23

Premiera të shfaqjeve

4

Artiste/ë teatri dhe staf teknik

+ **100**

Persona në audiencë:

+ **2000**

TRAJNIMET DHE PUNËTORITË

punëtori dhe trajnime:

+15

pjesëmarrës:

+400

EDICIONI I 13-të I FESTIVALIT FEMART

Aktivite të organizuara:

29

Artiste/ë/aktiviste/ë/staf teknik:

180

Shtete pjesëmarrëse:

19

Shikime në Facebook dhe Instagram

2,638,987

Persona në audiencë

3,036

Blogje të publikuara:

14

Lokacione në Prishtinë

9

Vullnetarë + 1 Koordinatorë

11

KLUBET TEATRORE DHE SHFAQJET FORUM TEATËR

Klube Teatrore:

4

Shfaqje forum teatër:

4

pjesëmarrës në klube dhe shfaqje:

58

persona në audiencë

+475

STATISTIKAT E MEDIAVE SOCIALE

ARTPOLIS // 1 Janar – 31 Dhjetor, 2025



1.4M

Shikime

17.8K

Vizita



965.1K

Shikime

177.1K

Arritje



Audienca: 11,823 pëlqime // Gra 68.1% // Burra 31.9%



Audienca: 3,209 ndjekës // Gra 70% // Burra 30%

FESTIVALI FEMART // 1 Janar - 30 Qershor 2025



378,011K

persona të arritur

1,473,339

Shikime

223

ndjekës

7,334

Interaksion në përbajtje

11,127

Vizita



244,110

persona të arritur

1,200,849

Shikime

674

ndjekës

23,605

Interaksion në përbajtje

10,968

Vizita



Audienca: 10,582 pëlqime // Gra 75.5% // Burra 24.5%



Audienca: 3,771 ndjekës // Gra 75.5% // Burra 24.5%

MONITORIMI I MEDIAVE

Gjatë vitit 2025 aktivitetet e Artpolis kanë pasur mbulueshmëri të gjerë nga mediat lokale dhe nacionale. Mbi 100 artikuj janë publikuar nga media të ndryshme dhe më poshtë mund të lexoni disa prej tyre:

KOHA

<https://www.koha.net/kulture/shkodra-elektronike-ne-loje-te-zjarre-me-zhurmat-e-perditshmerise>

<https://www.koha.net/shtojca-kulture/circle-fest-qar-kon-artistet-e-rinj-te-ballkanit-te-lodhur-nga-historia>

<https://www.koha.net/kulture/tales-of-scapes-nga-lahuta-tek-ia-ja-sfidon-edhe-konceptin-e-muzikes>

<https://www.koha.net/express-ktv/vojceku-le-je-honen-e-njeriut-te-tjetersuar-deri-ne-fund-tragjik-1>

<https://www.koha.net/kulture/revolte-ne-kohe-te-veshtire-me-butesine-e-vargut-fuqizon-rezistencen>

KULTPLUS

<https://www.kultplus.com/lajme/me-16-qershor-nis-edicioni-i-13-te-i-femart-festivali-nis-me-performancen-e-shkodres-elektronike/>

<https://www.kultplus.com/lajme/cliroje-mendjen-femart-prezanton-imazhin-e-edicionit-te-13-te/>

<https://www.kultplus.com/teatri/vojceku-sjell-perjetimin-trondites-te-padrejtensive-shoqerore-ne-naten-e-dyte-te-festivalit-moisiu/>

<https://www.kultplus.com/teatri/kujtime-nga-lumi-shfaqja-e-zana-hoxhes-qe-synon-te-thej-tabute-e-fenomeneve-ekzistenciale/>

KALLXO

<https://kallxo.com/gjate/shkodra-elektronike-hap-femart-13-zana-hoxha-festivali-strehe-per-ata-qe-kane-mbijetuar-dhe-skene-per-ata-qe-kane-per-te-treguar/>

<https://kallxo.com/kulture/shfaqja-vojceku-premiere-me-21-shkurt-ne-gjakove/>

TELEGRAFI

<https://telegrafi.com/artpolis-dhe-parlamenti-studentor-nisin-betejen-kunder-ngacmimit-seksual-ne-up/>

<https://telegrafi.com/n eser-mbahet-koncerti-shkodres-elektronike-ne-prishtine-shenohet-hapja-e-festivalit-femart/>

KLANKOSOVA

<https://klankosova.tv/festivali-femart-nis-son-te-me-shkodren-elektronike/>

<https://klankosova.tv/me-feste-muzikore-femart-mbyll-son-te-edicionin-e-13-te/>

<https://klankosova.tv/artpolis-prezanton-artin-feminist-ne-festivalin-wetoo-ne-paris/>

<https://klankosova.tv/shfaqja-a-po-mnin-premiere-son-te-ne-gjilan/>

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE



TË ARDHURAT

TË ARDHURAT € 526,065

TOTALI I TË ARDHURAVE € 526,065



SHPENZIMET

SHPENZIMET E PAGAVE E STAFIT / PERSONATE JASHTËM € 187,423

SHPENZIMET OPERATIVE € 334,957

SHPENZIMET E ZHVLERËSIMIT € 3,685



TOTALI I SHPENZIMEVE € 526,065

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA DONATORËT

	TË ARDHURAT	SHPENZIMET
KTK	€ 53,256	€ 53,256
UNFPA	€ 51,637	€ 51,637
CDF	€ 45,000	€ 45,000
FRIEDA	€ 85,092	€ 85,092
MINISTRIA E KULTURËS	€ 75,000	€ 75,000
KOMUNA E PRISHTINËS	€ 10,000	€ 10,000
EU	€ 49,583	€ 49,583
AMBASADA E AMERIKËS	€ 35,317	€ 35,317
AMBASADA E LUKSEMBURGUT	€ 10,000	€ 10,000
KBFUS	€ 22,930	€ 22,930
AMBASADA E FRANCËS	€ 5,000	€ 5,000
URGENT ACTION FUND FOR WOMEN'S	€ 4,705	€ 4,705
TË TJERA	€ 42,275	€ 33,767
TË HYRAT NGA ANËTARSIA	€ 60	€ -
ZYRA E PRESIDENTES	€ 5,000	€ 5,000
SWISS PEASE SNISS	€ 6,300	€ 6,300
DAH TEATER	€ 11,486	€ 11,486
HEDWIG STAUFFER STIFTUNG	€ 9,992	€ 9,992
TË HYRAT NGA SPONSORIZIMI	€ 12,000	€ 12,000
TË HYRAT E SHTYRA NGA VITI PARAPRAK	€ 101,337	
TË HYRAT E SHTYRA TË VITIT AKTUAL	€ (109,905)	
TË ARDHURAT TOTALE NGA DONATORËT	€ 526,065	€ 526,065

Pasqyrat financiare janë përgatitur për qëllime raportimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në fuqi dhe ato përfaqësojnë të gjithë pasqyrën që ka ndodhur në Artpolis gjatë vitit 2023. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parave të gatshme, sipas së cilës të ardhurat dhe shpenzimet njihen në kohën kur merren ose pa-

guhen. Organizata përdor Quick Books për të përgatitur pasqyrat financiare.

Më poshtë mund të gjeni linkun e Raportit të Auditimit të Artpolis për vitin 2025:

<https://artpolis-ks.com/raporti-i-auditit-2025/>

STAFI DHE BORDI I ARTPOLIS, 2025



Zana Hoxha, Themeluese dhe Drejtore Ekzekutive

Donarta Limanaj, Menaxhere e Financave dhe Administratës

Venera Ismaili, Menaxhere e Projekteve

Berat Bajrami, Koordinator i Projekteve dhe zyrtar për PR

Elira Lluka, Zyrtare për PR

Rudina Xhokli, Koordinatore e Projekteve

Drilona Hamiti, Asistente Kreative

Arbnora Kajtazi, Asistente e Financave

Erzë Salihu, Koordinatore e projekteve

Mimoza Musliu, Asistente e projekteve

Erzë Uka, Praktikante - përkthyesë

Rukije Gashi, Mirëmbajtëse e Zyrës

Anëtarët e bordit: Aurita Agushi, Jelena Memet, Kushtrim Qerimi, Dardan Kryeziu.

DONATORËT E ARTPOLIS

MKRS (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit), Frieda (Organizata Feministe e Paqes), KTK (Kvinna till Kvinna), BE (Bashkimi Evropian), UNFPA (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë), Global Fund for Women, Rrjeti i Grave të Kosovës, Ambasada e Luksemburgut, Ambasada e Francës, Banka Ekonomike.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT



FRIEDA
The Future is
Peace Organization



CDF
Center for Dialogue and Freedom



KVINNA
KVINNA



Funded by
the European Union



UNFPA



PRISHTINA



EMBASSY OF LUXEMBOURG
- PRISHTINE



UNITED STATES EMBASSY
PRISHTINA



AMBASSADE
DE FRANCE
AU KOSOVO
Liberté
Égalité
Fraternité



Banka
Ekonomike



Finnish School

RRJETET SOCIALE TË ARTPOLIS DHE FESTIVALIT FEMART

ARTPOLIS



Artpolis - Art and Community / <https://www.facebook.com/artpolisKosovo>



ArtpolisCenter / <https://www.instagram.com/artpoliscenter/>



QendraArtpolis / <https://twitter.com/qendraartpolis?lang=en>



Artpolis - Art and Community / <https://vimeo.com/artpoliscenter>



<https://artpolis-ks.com/>

FEMART



FemArt Kosova / <https://www.facebook.com/FemartKosova>



FemArtKosovo / <https://www.instagram.com/femartkosovo/>



FemArtKosovo / <https://twitter.com/FemArtKosovo>



FemArt Festival / <https://femart-ks.com/>



FemArt Festival / <https://bit.ly/3KoTtck>

